Lirimi i 'Dividentit të dytë Numerik' detyron rrjetet aktuale DTT të evakujnë 30% të kapacitetit të spektrit “post-switchover” për transmetimin tokësor. Kjo përbën një sfidë serioze për Shqipërinë pasi ky brez tashmë është i okupuar nga operatorë të rrjeteve numerike televizive kombëtarë, të licensuar përgjatë viteve 2016-2017, me të drejtë përdorimi të frekuencave për një afat kohor 15 vjet, pra deri në vitet 2031-2032, dhe gjithashtu është planifikuar për përdorim nga rrjetet numerike audiovizive vendore (Tabela 1).

Kanalet e caktuara për licencimin e operatorëve private kombëtare dhe atyre me eksperiencë në transmetimet numerike											
Numri Rrjeteve	Allot. Shkoder	Allot. Kukes	Allot. Diber	Allot. Lezhe	Allot. Tirane	Allot. Elbasan	Allot. Fier	Allot. Berat	Allot. Korçe	Allot. Gjirokastrer	Allot. Vlore
MUX 3	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
MUX 4	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
MUX 5	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
MUX 6	22	36	54	-----	57	46	29	24	21	48	-----
MUX 7	51	52	60	-----	39	40	45	47	27	35	-----

Kanalet e caktuara për licencimin e rrjeteve numerike të operatorëve private lokale e rajonale											
Numri Rrjeteve	Allot. Shkoder	Allot. Kukes	Allot. Diber	Allot. Lezhe	Allot. Tirane	Allot. Elbasan	Allot. Fier	Allot. Berat	Allot. Korçe	Allot. Gjirokastrer	Allot. Vlore
9		56(DD2)	63(DD1)		61(DD1)	56(DD2)	51(DD2)	54(DD2)	57(DD2)	50(DD2)	
10		65(DD1)	69(DD1)			58(DD2)		61(DD1)	59(DD2)	53(DD2)	
11						62(DD1)		65(DD1)	64(DD1)	56(DD2)	
12						68(DD1)		66(DD1)		58(DD2)	
13										60(DD2)	
14										63(DD1)	
15										67(DD1)	
16										69(DD1)	

■ Kanalet që okupohen nga DD2, ----- Kanalet që okupohen nga DD1

**TABELA 1: KAPACITETET E TRANSMETIMIT NUMERIK TELEVIZIV NË SHQIPËRI ([www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al))**

Shqipëria është konsideruar rasti më i vështirë në rajon për lirim të Dividentit të Dytë Numerik.

Plani GE-06 u bazua në sistemin e transmetimit video digjital tokësor (DVB-T) i përshkruar si “Sistemi B” në Rekomandimin ITU-R BT.1306-3.

Për të lejuar përdorimin më të mirë të burimeve të spektrit, në vitin 2009 konsorciumi DVB botoi kushtet specifike për teknologjitë DVB-T2 si një zgjerim i standardit ekzistues DVB-T. Një zgjerim i tillë rezulton në rritjen me 30-50% të efektshmërisë së DVB-T2-shit kundrejt DVB-T-së.

Duke marrë në konsideratë tregun e mediave televizive në Shqipëri me një numër relativisht të madh të operatorëve të transmetimeve analoge televizive (rreth 72 operatorë) si dhe detyrimin për të liru Dividentët Numerik u vendos me akte ligjore detyrimi që Shqipëria të kalonte direkt në implementimin e sistemit më të avancuar DVB-T2.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë krahasimin midis dy tipeve të rrjetit numerik të transmetimit MFN (Rrjet me Shumë Frekuenca) dhe SFN (Rrjet me Frekuencë të Vetme), u përzgjedh më i favorshëm përdorimi i rrjeteve SFN, të cilat rrisin konsiderueshëm efikasitetin në përdorimin e burimit frekuencor.

Rrjetet numerike kombëtare apo rajonale në Shqipëri kanë përfituar nga avantazhet e përdorimit të rrjeteve SFN dhe teknologjia DVB-T2, përveç se SFN-të kanë ende përmasat e që ofron DVB-T, të miratuara nga Plani GE-06.

Rritja e përmasave SFN ofruar nga teknologjia DVB-T2 deri në dyfishimin e përmasave SFN bazuar në teknologjinë DVB-T2 përbën një faktor të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve frekuencore. Bazuar në Marrëveshjen GE-06, ndryshimet e madhësive të rrjeteve SFN që shkaktojnë interferenca me administratat fqinje që ndodhen brenda një rreze 1000 km, kërkojnë koordinim intensiv. Në rastin e Shqipërisë, nevojitet koordinimi me 14 administrata gjë që kërkon një diapazon kohor të konsiderueshëm.

Në kushtet kur lirim i DD2 duhet të përfundojë brenda një afati relativisht të shkurtër, ky punim synon gjetjen e zgjidhjeve teknike që mundësojnë zgjerimin e madhësive SFN pa ndryshuar pozicionin apo fuqinë e transmetimit të transmetuesve për të shmangur interferencat e jashtme dhe si rrjedhim koordinimin me administratat fqinje. Duke marrë në konsideratë që hapësirat e mbuluara nga një SFN (alotmentet) janë pothuajse të përshtatura me ndarjet administrative me qëllim ofrimin e programeve rajonale apo lokale, ky studim teston rritjen e përmasave të një rrjeti SFN deri në mbulimin alotmentit që shërbehet nga rrjeti SFN fqinje, pa krijuar interferenca të jashtme. Gjithashtu, rritja e përmasave të rrjetit SFN do të bëhet në

kushtet e ruajtjes apo përmirësimit të kapacitetit të transmetimit (bps) dhe cilësisë së shërbimit (QoS).

Bashkimi i dy SFN-ve egzistuese në një të vetme do të mundësonte lirim të një frekuence të brezit DD2.

Është e rëndësishme të theksohet që vendet fqinjë kanë përfunduar procesin e digjitalizimit të transmetimeve TV dhe të lirit të dividentit të parë numerik dhe janë në proces të lirit të dividentit të dytë numerik, të cilat do të përdorin së shpejti për shërbimet e lëvizshme me brez të gjerë. Çdo vonesë në lirim të dividentit të dytë numerik në Shqipëri do të krijonte probleme serioze interferencash të ndërsjellta me vendet fqinjë.

Për sa më sipër, qëllimi i këtij disertacioni është rritja e efikasitetit të spektrit, të përcaktuar për transmetimet numerike tokësore televizive, duke rritur përmasat SFN, deri në bashkimin e dy SFN-ve egzistuese, nëpërmjet qasjes më të mirë të sistemeve të transmetimit DVB-T2 në Planin GE06, gjë që do të mundësojë lirim të një frekuence të Dividentit të dytë Digjital (DD2).

Kontributi i kësaj teze është se bashkimi i dy rrjeteve SFN-ve egzistuese duke ruajtur apo përmirësuar kapacitetin dhe cilësinë e transmetimit bëhet pa prekur Marrëveshjen GE-06, që do të thotë që në SFN-në e re densiteti i fuqisë “peak” në çdo 4 kHz nuk do të kalojë densitetin e fuqisë spektrale në të njëjtën 4 kHz të hyrjes numerike në planin GE-06.

## 1.5 METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Ky punim është bazuar në literaturën bashkëkohore të organizatave ndërkombëtare /europiane si Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU), Bashkimi i Transmetuesve Audiovizivë Europianë (EBU), modeleve teorike të rekomanduara në to, studimeve të ngjashme dhe eksperiencave të zbatuara në vende të tjera.

Zgjidhjet përkatëse teknike që lidhen me qasjen më të mirë të sistemit të transmetimit DVB-T2 në Planin GE-06, pa prekur këtë plan, synojnë investigimin e mundësisë së rritjes së përmasave të rrjetit SFN deri në mbulimi të dy SFN-ve egzistuese fqinjë, duke liru një frekuence të brezit të Dividentit të dytë Numerik.

Studimi merr në konsideratë modelet teorike të zgjerimit të rrjetit SFN, modelet e llogaritjes së interferencave të brendshme dhe të jashtme, modelet për rillogaritjen e distancës së ripërdorimit të frekuencave si dhe modelet e llogaritjes së sinjalit në marrje. Modelet teorike SFN janë përdorur si një mjet për të përzgjedhur konfigurime optimale për skenarin e mbulimit që i përgjigjet qëllimit të këtij studimi. Në analizën e konfigurimeve të rrjetit, është mbajtur

në vëmëndje ruajtja e performancës së rrjetit dhe plotësimi i kriterëve dhe kufizimeve të Marrëveshjes komplekse GE-06.

Në përzgjedhjen e konfigurimeve të rrjetit janë marrë në konsideratë, gjithashtu, marrëveshjet e koordinimit me vendet fqinjë për ndarjen dhe përdorimin e frekuencave për transmetimet numerike.

Qasje të ndryshme kërkimore për të ofruar një analizë gjithëpërfshirëse mbi aspekte të ndryshme të problemit kanë shërbyer gjithashtu si referenca të vlefshme. Këto studime përmbajnë analiza dhe rezultate të ngjashme.

Për optimizimin e mbulimit bazuar në simulime të intervalit të mbrojtës dhe vonësive statistike është përdorur programin profesional i planifikimit të frekuencave audio/audiovizive “HTZ Communications”.

## 1.6 ANALIZA KRAHASIMORE ME PUNIME TË NGJASHME

Një studim i realizuar nga Li C.W., Telemi. S. Member IEEE, Zhang X.L., Brugger R., Angulo I., Member IEEE, Angueira P., Senior Member, IEEE, analizon, ashtu si dhe në këtë punim, marrëdhënien e ngushtë midis e.r.p. së rrjetit, distancës maksimale ndërmjet transmetuesit, distancës së ripërdorimit dhe kufijve të raportit C/N, e cila përcakton shpejtësinë e bitit; Studimi ka treguar realizimin e SFN-ve të mëdha me karakteristika të transmetuesve si në rastin e studimit tonë;

Gjithashtu, PROGIRA (prodhuar i software-ve për rrjetet radio-televizive), në studimin “High and Low Tower Broadcast Networks”, krahason topologjitë e rrjetit dhe efikasitetin e spektrit për rrjetet e transmetimit HT (High Tower) dhe LT (Low Tower) (Rrjetet Europiane Broadcast (BNE)). Studimi vlerëson hapësirat për të zvogëluar kërkesat e spektrit për SFN më të mëdha duke përdorur DVB-T2 pa ndryshuar infrastrukturën ekzistuese dhe me të njëjtat kapacitete transmetuese. Rezultatet tregojnë se SFN-të më të mëdha se afërsisht 200 km, mund të realizohen me rrjete kombëtare HT (High Tower) me mesatarisht 4 frekuenca.

Faktori i ripërdorimit të frekuencës është i pavarur nga arkitektura e rrjetit (HT ose LT) për sa kohë që zonat e mbulimit të SFN-së janë mjaft të mëdha.

Shëmbuj optimizimi të mbulimit bazuar në simulime të vonësive statistike janë realizuar me sukses në dy rrjete SFN në Baskia (Spanjë) dhe ishulli Sardinia (Itali). Mbulimi është përmirësuar duke minimizuar zonat që vuajnë nga vetë interferenca. Studimi ka demonstruar efikasitetin e algoritmeve heuristike në optimizimin e mbulimit.

Në të dy studimet e sipërpërmëndura ka patur një përmirësim të mbulimit në të cilat kanë rezultuar në përmirësime të kënaqshme të mbulimeve konkretisht në marrje fikse (DVB-T2

8K). Simulimi i përdorur ka kombinuar heuristikën SA (simulated annealing) dhe ASA (advanced simulated annealing) dhe një mjet parashikimi të përhapjes me objektivin përfundimtar të optimizimit të mbulimit të rrjetit SFN duke zvogëluar zonat e vet interferuara në vendet Baske (DVB-T / T2) dhe ishullin e Sardeniës (DVB-T2). Rezultatet tregojnë se mbulimi rritet deri në 4.9% në Baskia, Spanjë, (DVB-T 8K) dhe deri në 7% në ishullin e Sardeniës (DVB-T2 8K) për marrësit fiks.

## KAPITULLI II

### RRJETET E TRANSMETIMEVE NUMERIKE TELEVIZIVE NË PLANIN GE-06

#### 2.1 PARATHËNIE

Transmetimi televiziv tokësor është në përfundim të një tranzicioni revolucionar në epokën numerike në mbarë botën. Ky revolucion është i dyti më i madhi në sektorin e mediave televizive që nga tranzitimi i TV-së bardh e zi në atë me ngjyra.

Përfitimi galopant i përfshirjes së botës televizive në epokën numerike lidhet me përdorimin më të kursyer të burimit frekuencor, i cili përbën një aset në ndërtimin e shoqërive të sotme moderne digjitale. Tashmë:

- më shumë të dhëna të transmetuara për njësi bandwidth-i dhe si rrjedhim rritje në kapacitetin e rrjeteve transmetuese audiovizive duke përmirësuar efikasitetin e spektrit;
- ofrimi i cilësisë më të mirë të sinjalit nëpërmjet rritjes së qëndrueshmërisë së transmetimeve kundrejt interferencave dhe degradimit të figurës. Suportimi i shërbimeve HD dhe interaktive.

#### 2.2 STANDARTET E TRANSMETIMIT NUMERIK TELEVIZIV

Siç duket dhe në Figurën 2, për transmetimin tokësor të programeve televizive numerike në rang ndërkombëtar përdoren katër sisteme konkurruese:




FIGURA 2: BASHKËJETESA E STANDARTEVE TË TELEVISIONIT NUMERIK NË MBARË BOTËN (DVB-PROJECT)



- ISDB-T (Transmetimi Digital i Shërbimeve të Integruara Tokësore) në Japoni.
- SBTVD-T (Sistemi Brazilian i Televizionit Digital Tokësor) në Brazil.
- DMB-T/H (Digital Multimedial Transmetim-Terrestrial / Handheld) në Kinë.
- Standardi ATSC në SHBA.

Projekti DVB është realizuar në Europë nga EBU (European Broadcasting Union), ETSI (Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit) dhe CENELEC (Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik). Për transmetimet tokësore përdoret standardi DVB-T (Digital Video Broadcasting Terrestrial).

DVB është një industri që udhëheq mbi 270 rrjete transmetimi televizive. DVB është adoptuar si standardi i televizionit numerik në shumë shtete. Tre standardet kryesore të sisemit DVB dhe më të përdorura janë DVB-S për rrjetat satelitore, DVB-C për rrjetat kabllore dhe DVB-T për rrjetet tokësore.

Viti 2009 shënoi kompletimin e familjes të standardit DVB me gjeneratat e dyta DVB-T2, DVB-C2 dhe DVB-S2. Këto sisteme transmetimi ndryshojnë kryesisht nga skema e modulimit dhe kodet e korigjimit të gabimeve.

### 2.3 PLANI GE-06

Marrëveshja e Gjenevës (GE-06) *“Për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike tokësore në pjesë të Rajoneve 1 (pjesë të Rajonit 1 që ndodhen në perëndim të meridianit 170°E dhe në veri të paraleleve 40°S, përveç territorit të Mongolisë) dhe në Republika Islamike e Iranit, në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz”* u miratua nga Konferenca Rajonale e Radiokomunikacionit në qershor 2006.

Për ndarjen e frekuencave për shërbimet e transmetimeve numerike tokësore për Rajonin 1, Marrëveshja GE-06 u bazua në teknologjinë DVB-T.

Parimi bazë i kësaj Marrëveshje është ndarja e barabartë e spektrit të frekuencave ndërmjet vendeve anëtare të Rajonit 1 të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve, të cilat kanë nënshkruar këtë marrëveshje, ashtu si dhe vendi ynë.

Në Planin GE-06, kapaciteti total në dispozicion është i shprehur në numrin e multipleksrave (shtresave), të cilat mbulojnë me shërbim të gjithë territorin e një vendi. Një shtresë përfaqëson një grup kanalesh që mund të përdoret për të siguruar një mbulim të plotë ose të pjesshëm kombëtar. Për shumë shtete Evropiane kjo është ekuivalente me:

- Tre shtresa T-DAB në Brezin III
- Një shtresë DVB-T në Brezin III
- Shtatë deri në tetë shtresa DVB-T në Brezin IV/V

Një hyrje në Planin GE-06 nënkupton një multiplekser DVB-T me zonën përkatëse të mbulimit. Kjo vlen si për caktimet frekuencore “assignment” ashtu edhe për alotmentet. Alotmentet janë mbulimi i realizuar nga një caktim frekuencor i vetëm që funksionon si një Rrjet me Frekuencë të Vetme (SFN). Për mbulime kombëtare, rajonale opo lokale përdoren disa plane hyrëse.

Bazuar në aktet finale të kësaj Marrëveshje për çdo administratë nënshkruese janë miratuar:

- karakteristikat specifike të stacioneve të transmetimit brenda Zonës së Planifikimit në brezat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz,
- rregullat për modifikimin e këtyre karakteristikave ose vendosjen e stacioneve të reja sipas dispozitave përkatëse të neneve 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshje.
- zbatimi i neneve 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshje për shërbimet e tjera parësore tokësore, për të cilat janë përcaktuar këto breza.

Parimi bazë i Planit të Gjenevës është që subjektet e regjistruara të mbrohen dhe që çdo aktivizim i ri të përputhet me subjektet e regjistruara në plan. Kur një kërkesë e re koordinimi konkludohet pozitivisht, subjekti i koordinuar bëhet pjesë e planit me të njëjta të drejta. Në rast të një kërkesë të re koordinimi, negociimi midis shteteve anëtare në përgjithësi kërkojnë një afat kohor rreth 3 vjet.

## 2.4 GJENERATAT E FUNDIT TE TRANSMETIMIT (DVB-T2) DHE KOMPRESIMIT (MPEG-4)

Dy vjet mbas miratimit të Marrëveshjes GE-06, në qershor 2008 Projekti DVB lançoi DVB-T2 si standardin e ri të transmetimit tokësor, i cili u miratua nga Instituti i Standardeve Evropiane të Telekomunikacionit (ETSI) në shtator 2009.

DVB-T2 prezanton teknikat më të fundit të modulimit dhe kodimit për të mundësuar përdorimin më efikas të spektrit për shpërndarjen e shërbimeve audio, video dhe të të dhënave në pajisje fikse, portabël dhe të lëvizshme.

Standardi DVB-T2 ofron një diapazon shumë më të zgjeruar të zgjedhjeve të parametrave teknik, të cilat së bashku me kodimin e përmirësuar të korrigjimit të gabimit lejojnë një rritje të kapacitetit deri në gati 50% për funksionimin e rrjeteve MFN dhe madje edhe më i lartë për funksionimin e SFN.

DVB-T2 ofron gjeneratën e re FEC (mbrojtje nga gabimi) dhe modulimin (256-QAM) duke rezultuar në një rritje kapaciteti mbi 30% duke iu afruar kufirit Shannon. Numri maksimal i bartësve OFDM rritet nga 8k në 32k. Intervalit të mbrojtjes i shtohen gjatësitë: 1/128, 19/256, 19/128. Në ndryshim nga DVB-T që përdor modelin pilot të vazhduar, DVB-T2 zbaton modelin pilot të shpërndarë sipas gjatësisë së intervalit të mbrojtjes (GI) duke zvogëluar me 10% pjesën “overhead” të simbolit.

DVB-T2 gjithashtu shton tre gjerësi brezi sinjali të reja 1.7 MHz, 5 MHz dhe 10 MHz. Kombinimi i skemave të ndryshme të modulimit me madhësinë FFT dhe intervalet e mbrojtjes lejon ndërtimin e rrjeteve MFN dhe SFN të dizenuara për aplikime të ndryshme: nga marrja e lëvizshme me shpejtësi të ulët por e fuqishme te marrja fikse me shpejtësi të lartë për përdorim në ambiente shtëpie dhe zyre.

Një nga avantazhet e DVB-T2 krahasuar me pasardhësin e tij DVB-T është rritja zonave të mbulimit të rrjeteve SFN, kryesisht duke mbajtur konstant karakteristikat e transmetuesit, cilësinë e videos dhe numrin e programeve.

Standardi i gjeneratës së dytë, DVB-T2, ofron kapacitetet transmetimi 30-50% krahasuar me DVB-T në kushtet e përdorimit të antenave ekzistuese marrëse.

DTT ka rritur me tej kapacitetet e transmetimit me duke kombinuar DVB-T2 me gjeneratën e fundit të kompresimit MPEG-4.

MPEG-4 (H.264) është një standard kompresimi video dhe audio i përmirësuar që mundëson rritjen deri në dyfishin e efikasitetit kundrejt standardit të kompresimit MPEG-2. Kjo do të thotë që një Multiplexer DTT mund të mbështesë deri dy herë me shumë programe kur përdor MPEG-4 në krahasuar me MPEG-2, me të njëjtin kualitet figure dhe zëri.

Kombinimi i dy teknologjive DVB-T2 dhe MPEG4 rrisin kapacitetin e një Multiplekseri (MUX) deri në 160% për marrjen fikse, megjithatë disa ekspertë këmbëngulin për mundësi rritje deri në vlerën 100%. Për këtë arsye dhe duke marrë parasysh numrin konsiderueshëm të lartë të rrjeteve televizive në vendin tonë, zbatimi i standarteve DVB-T2 dhe MPEG-4 u bë një detyrim ligjor.

Nëpërmjet kompresimit MPEG4 bëhet i mundur transmetimi i 4 ose 5 programeve HDTV për multiplekser për marrjen fikse, ose 2 deri 3 programe HDTV në multiplekserin për marrje portabël ose të lëvizshme.

Maksimumi i kapacitetit në dispozicion në Planin GE-06 në termat e numrit të programeve në kushtet e kombinimit të DVB-T2 me MPEG-4 si është si më poshtë:

	Brezat UHF IV/V	Brezi VHF III
<b>DVB-T</b>	7-24	1-3
<b>DVB-T2</b>	21-40	4-5

TABELA 2: KAPACITETIT I OFRUAR NË PLANIN GE-06

Të dhënat në tabelën e mësipërme bazohen në supozimet e mëposhtme:

- shumica e shteteve kanë në Planin GE-06 7-8 shtresa në UHF dhe 1 shtresë në VHF;
- të gjitha hyrjet e Planit DVB-T do të përdoren për të siguruar shërbimet HDTV;
- performanca e enkoderave MPEG-4, të cilët vazhdojnë të evoluojnë, janë mjaftueshëm të avancuar për implementimin e DVB-T2.

Duhet të kuptohet se këto kushte nuk mund të jenë gjithmonë të aplikueshme në praktikë. Maksimumi i shpejtësisë së bitit mund të arrihet vetëm me përdorimin e SFN-ve në intervale të shkurtra mbrojtje, përndryshe shpejtësia neto aktuale e bitit është më pak se maksimumi i deklaruar.

## 2.5 PLANI GE-06 DHE KAPACITETET E TRANSMETIMIT PËR HDTV

Në një studim të realizuar nga Komiteti Teknik Europian EBU, është parashikuar se në të ardhmen të gjitha programet TV do të jenë në kualitetin HD dhe se minimumi 20 deri në 25 programeve do të ofrohen nga platforma tokësore.

Plani i transmetimit numerik GE-06 bazon implementimin e shërbimeve HDTV në përdorimin e teknologjisë DVB-T. Por jo të gjithë regjistrimet DVB-T në Planin GE-06 ofrojnë të njëjtën mundësi për HDTV, kryesisht për shkak të referencave të ndryshme të konfigurimit për planifikimin (RPC) ose varianteve të sistemit të përdorura për krijimin e Planit GE-06. Sidoqoftë, Plani GE-06 premtion një shkallë të konsiderueshme të fleksibilitetit në implementimin e rrjetave të transmetimit që mund të përdoren në favor të HDTV.

Një program HD kërkon një “bit rate” fiks 10-20 Mbit/s në varësi të formatit dhe metodës së përdorur të kompresimit (p.sh. MPEG-2 ose MPEG-4). Në zhvillimet e ardhshme në kodimin video, është supozuar se “bit rate” fiks i rekomanduar për HD do të reduktohet në 8-10 Mbit/s për program. Nëse aplikohet multipleksori statistikor arrihet një “bit rate” mesatar 7-8 Mbit/s për program HD, të cilat nëse multipleksohen së bashku në një multipleksor DVB-T kërkojnë një shpejtësi të transmetimit të bitit 24 Mbit/s).

Një multipleksor DVB-T ofron shpejtësi të transmetimit të bit-it që varion nga 8 Mbit/s (QPSK, 2/3) në 27 Mbit/s (64 QAM, 3/4) dhe teorikisht mund të arrijë të transmetojë një deri

në tre programet HD për marrjen fikse dhe një maksimum prej një ose dy programe HD për variantet e marrjes portabël dhe të lëvizshme.

## 2.6 KAPACITETET E TRANSMETIMIT NË PLANIN KOMBËTAR TË FREKUENCAVE NUMERIKE

Plani Shqiptar i Frekuencave Numerike, i miratuar me Marrëveshjen GE-06, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, përfshin:

- 7 mbulime kombëtare me DVB-T (Televizion Numerik Tokësor) në brezin UHF
- 1 mbulim kombëtar me DVB-T në brezin VHF
- 2 mbulime kombëtare me T-DAB (radio numerike) po në brezin VHF

Përveç mbulimeve kombëtare, plani përfshin edhe mbulime lokale:

- Suballotmenti i Tiranës me 7 mbulime lokale DVB-T në UHF, 1 mbulim në DVB-T VHF dhe 2 mbulime në T-DAB VHF.
- Planifikimi i një numri frekuencash për mbulime lokale në disa zona të Shqipërisë.

### 1. Për DVB-T në UHF:



### 2. Për DVB-T në VHF



### 3. Për T-DAB në VHF (Radio numerike)



FIGURA 3: FORMAT E ALLOTMENTEVE TË PLANIT NUMERIK ([www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al))

Tabela e mëposhtme paraqet kapacitetet transmetuese të Planit të Frekuencave Numerike të Shqipërisë të miratuara nga Marrëveshja GE-06. Në tabelë janë paraqitur frekuencat, përdorur nga një SFN për mbulimin e secilit allotment. Rreshtat me të njëjtën ngjyrë paraqesin kombinimet e frekuencave (SFN-ve) të allotmenteve për një rrjet numerik MFN me mbulim kombëtar.

Mbulimet	Allotmenti Shkodër Kanali TV	Allotmenti Kukes Kanali TV	Allotmenti Diber Kanali TV	Allotmenti Lezhe Kanali TV	Allotmenti Tirane Kanali TV	Allotmenti Elbasan Kanali TV	Allotmenti Fier Kanali TV	Allotmenti Berat Kanali TV	Allotmenti Korçe Kanali TV	Allotmenti Gjokastër Kanali TV	Allotmenti Vlorë Kanali TV	Mbulimet	Sub Allotmenti Tirane
Mb. 1 Kombëtar	1	3	5	7	9	11	13	15	17	19	21		Kanali TV
Mb. 2 Kombëtar	22	26	24	23	21	23	22	24	21	26	23	Mbulimi 1	26
Mb. 3 Kombëtar	28	32	25	29	34	33	27	25	27	29	38	Mbulimi 2	37
Mb. 4 Kombëtar	31	35	37	35	38	35	38	35	38	35	37	Mbulimi 3	44
Mb. 5 Kombëtar	41	40	36	43	53	42	29	32	43	37	46	Mbulimi 4	50
Mb. 6 Kombëtar	45	42	54	46	57	46	31	36	45	36	57	Mbulimi 5	60
Mb. 7 Kombëtar	51	50	55	66	59	46	35	47	51	44	64	Mbulimi 6	64
Mb. 8 Kombëtar	59	52	60	69	61	49	45	52	55	46	60	Mbulimi 7	67
Mb. Vendore		56	63			56	51	54	57	50			
Mb. Vendore		65	69			58		61	59	53			
Mb. Vendore						62		65	64	56			
Mb. Vendore						68		66		58			
Mb. Vendore										60			
Mb. Vendore										63			
Mb. Vendore										67			
Mb. Vendore										69			

**Plani Kombëtar i Frekuencave Numerike (GE-06)**

**TABELA 3: KAPACITETET TRANSMETUESE TE PLANIT KOMBËTAR NUMERIK (www.ama.gov.al)**

Bazuar në Planin e Frekuencave Numerike në Shqipëri, frekuencat e brezit DD2 përdoren në masën 24.5% nga transmetimet televizive tashme numerike. Duke marrë në konsideratë edhe përqindjen e përdorimit të frekuencave DD1, Plani Kombëtar i Frekuencave Numerike ka një reduktim në masën 43% të kapacitetit frekuencor krahasuar me atë të miratuar nga Marrëveshja GE-06.

Sa më sipër, qartëson se lirimi i Dividentit të dytë Numerik DD2 (694-790 MHz) përbën një sfidë serioze për Shqipërinë, një detyrim në kuadër të respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve dhe statusit aktual të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

## 2.7 QASJA E DVB-T2 NË PLANIN GE06

Marrëveshja GE-06 lejon zbatimin e DVB-T2 nën konceptin e zarfit; d.m.th. me kusht që ajo të mos shkaktojë më shumë ndërhyrje dhe as të kërkojë mbrojtje më të lartë se hyrja/regjistrimi në Planin GE-06.

Implementimi i një sistemi DTT DVB-T2 në Planin GE-06 lejohet në respektim të kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të trajtuara në detaje në Kapitullin IV të saj. Ruajtja e niveleve

të interferencave dhe kërkesat e maskës së spektrit që përcakton Marrëveshja GE-06 janë arsyeja pse zbatimi i standardit DVB-T2 shmang nevojën për të rinegociuar një traktat të madh ndërkombëtar që përfshin mbi 110 vende. Standardi DVB-T2, gjithashtu, është në përputhje me kërkesat e Radio Rregulloreve të ITU-së, kuadrin ndërkombëtar që rregullon përdorimin e spektrit të frekuencave dhe orbitave satelitore.

RRC-06 miratoi DVB-T si sistemin e transmetimit televiziv për të cilin u zhvillua Plani GE-06. Marrëveshja GE-06 miratoi këtë sistem të transmetimit si të vetmin për modifikimin e Planit, sic përshkruhet në Nenin 4 të saj. D.m.th vetëm ky sistem transmetimi mund të përdoret kur kërkohen modifikime në transmetimin TV në Plan. Kjo nënkupton që nëse një shtet anëtar që ka firmosur Marrëveshjen GE-06 dëshiron të zbatojë caktimin frekuencor duke përdorur DVB-T2 ose një sistem tjetër transmetimi, atëherë caktime të tilla frekuencore duhet së pari të paraqiten si modifikime të Planit, duke treguar se janë përdorur karakteristikat teknike të sistemeve të transmetimit DVB-T.

Kur hyrja e Planit të vihet në veprim, administrata mund të njoftojë sistemin aktual të transmetimit (p.sh. DVB-T2) sipas Nenit 5 të Marrëveshjes GE-06. Sipas kësaj dispozite, një zbatim i tillë është i kufizuar të mos shkaktojë më shumë interferenca ose të kërkojë një nivel më të lartë mbrojtjeje sesa hyrja në Planin origjinal.

Konsiderohet e rëndësishme që implementimi i DVB-T2 të përdor caktimet frekuencore të DVB-T dhe allotmentet e Planit GE-06, në mënyrë që të shmanget ri-planifikimi dhe kjo rrit kompleksitetin në zbatimin e DVB-T2. Për këtë arsye, zbatimi i DVB-T2 duhet të ruaj nivelet e interferencës dhe kërkesat e maskës së spektrit siç përcaktohet nga GE-06, sipas të cilës dendësia e fuqisë kulmore mbi çdo 4 kHz të një zbatimi të tillë nuk duhet të kalojë dendësinë e fuqisë së pikut në të njëjtin 4 kHz të hyrjes në Planin përkatës të transmetimit digjital”.

Si rrjedhim DVB-T2 i zbatuar në Planin GE06:

- duhet të ofrojë raporte të njëjta ose më të mira mbrojtjeje dhe vlera minimale të mesatares së fuqisë të fushës për variante të përshtatshme ekuivalente;
- mund të përdorë të njëjtin polarizim linear (të vetëm ose të përzier) të hyrjes së Planit të Transmetimit Digjital;
- mund të realizojë të njëjtat zona mbulimi duke përdorur nivele të njëjta ose më të ulta të fuqisë së rrezatuar;
- mban densitetin e njëjtë ose më të ulët të fuqisë së pikut për variantet që operojnë në të njëjten brez dhe kanë të njëjtin numër ose më të madh të transportuesve OFDM (madhësia FFT) për të njëjtat nivele të fuqisë së rrezatuar.

- duhet të ruaj dendësi të njëjtë ose më të ulët të fuqisë së pikut për variantet që veprojnë në të njëjtën gjerësi brezi dhe që kanë të njëjtin numër ose më të madh të transportuesve OFDM (madhësia FFT) për të njëjtat nivele të fuqisë së rrezatuar.

DVB-T2 ofron fleksibilitet të mjaftueshëm për sa i përket numrit të varianteve që ofron për të ruajtur të njëjtën hapësirë mbulimi dhe për të lejuar funksionimin e një caktimi frekuencor brenda kufizimeve që Marrëveshja GE-06 (Neni 5.1.3). Për të siguruar që implementimi i DVB-T2 respekton kufizimet e fuqisë së rrezatuar jashtë gjerësisë së brezit të veprimit, zbatimi DVB-T2 duhet të përputhet me maskën e spektrit të hyrjes korresponduese në Planin GE-06 siç është përcaktuar në Marrëveshjen GE-06.

Karakteristikat teknike të zbatimit të DVB-T2 duhet të jenë të tilla që të gjejnë konfigurime të favorshme që garantojnë konformitetin me hyrjen përkatëse të Planit GE06 (Seksionin II, Shtojcës 4, dhe Rregullore dhe Procedura, Pjesa A10/GE06 5.1.3, vendimet 1 në 3). Vetëm implementimet e DVB-T2 që janë në përputhje me hyrjen përkatëse të Planit Digjital do të regjistrohen.

Rekomandimi ITU-R BT.1877 tregon se varianti i kanalit 8 MHz në DVB-T2 (i përdorur aktualisht në rrjetet SFN që janë objekt i këtij studimi) është në përputhje me Planin GE06. Paqartësi mbetet në lidhje me zbatimin e varianteve dhe / ose opsioneve të ndryshme DVB-T2, për shembull, modaliteti i zgjatur i bartësit dhe gjerësia shtesë e brezit. P.sh. varianti me FFT 1k për kanalin 8 MHz nuk është kompatibël me GE-06 DVB-T.

Modulimi	Madhësia FFT	Shpejtësia e kodit	Intervali i Mbrojtjes
QPSK ose 16-QAM ose	2k	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/32, 1/16, 1/8, 1/4
64-QAM ose 256-QAM	4k	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/32, 1/16, 1/8, 1/4
	8k	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/128, 1/32, 1/16, 19/256, 1/8, 19/128, 1/4
	16k	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/128, 1/32, 1/16, 19/256, 1/8, 19/128, 1/4
	32k	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/128, 1/32, 1/16, 19/256, 1/8, 19/128
	8k extended	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/128, 1/32, 1/16, 19/256, 1/8, 19/128, 1/4
	16k extended	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/128, 1/32, 1/16, 19/256, 1/8, 19/128, 1/4
	32k extended	1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6	1/128, 1/32, 1/16, 19/256, 1/8, 19/128

**TABELA 4: VARIANTET DVB-T2 ME KANAL 8 MHz TË PËRSHTATURA PËR GE-06 (ITU-R BT.1877)**



Është e rëndësishme të theksohet se nëse aplikohet filtrim i përshtatshëm, të gjitha sinjalet RF në DVB-T2 mund të zbatohen në përputhje me maskën e spektrit përkatës të Marrëveshjes GE-06.

Për sa i përket potencialit të tyre të interferencave, të gjitha variantet e sistemit DVB-T2 1.7 MHz, 7 MHz dhe 8 MHz (përfshirë të gjitha madhësitë FFT, si dhe gjerësitë e brezit normal, ose të shtrirë) mund të përdoren për sa kohë që maska e spektrit GE-06 respektohet. Kjo e bën DVB-T2 të vështirë për tu zbatuar nga administratat kur ato janë regjistruar në MIFR.

### 2.7.1 MODIFIKIMI I PLANIT GE-06

Marrëveshja GE-06, në nenin 4 të saj, konsideron modifikime të Planit GE-06:

- a) ndryshimet e karakteristikave të një alotmenti, ose të një caktimi frekuencor në një stacion transmetimi, të miratuara në Plan;
- b) shtimin në Plan të një alotmenti ose të një caktimi frekuencor në një stacion transmetimi; ose,
- c) shtimin në Planin Digjital të një caktimi frekuencor që buron nga një alotment në Planin Digjital; ose
- d) anulimin nga Plani të një alotmenti, ose një caktimi frekuencor në një stacion transmetimi.

Sic edhe duket, rasti i trajtuar në këtë punim i përket tipit të modifikimeve në pikat a) dhe d) më sipër.

Administrata që propozon të ndryshojë karakteristikat e një caktimi frekuencor/alotmenti në Plan, duhet të kërkojë marrëveshjen e çdo administrate tjetër, të cilat konsiderohen se preken nga këto ndryshime.

Një administratë konsiderohet se preket në lidhje me shërbimin e saj të transmetimit kur tejkalohe kufijtë e dhënë në maskën e spektrit që përcakton Marrëveshja GE-06.

Në studim qëllimi është bashkimi i dy alotmenteve, të shërbyera secila nga një rrjet SFN, në një allotment të vetëm që do të mbulohet vetëm nga një rrjet SFN aplikohen modifikimet që i përkasin rastit c) dhe d). Për të garantuar që nuk do të tejkalohe kufijtë e dhënë në maskën e spektrit që përcakton Marrëveshja GE-06, domethënë që modifikimet në plan nuk do të prekin (shkaktojnë interferenca) administrat fqinjë, këto modifikime do të bëhen pa ndryshuar pzcionet gjeografike të transmetuesve, fuqitë e tyre të transmetimit dhe pa shtuar transmetues të rinj, përveç se përsëritësa (gap-filler) me fuqi 50W.

## 2.7.2 ADMINISTRATAT E PREKURA POTENCIALISHT NGA MODIFIKIMET NË PLAN

Identifikimi i administratave të prekura potencialisht ka si qëllim përcaktimin e sipërfaqes ku modifikimi i Planit prek parametrat e përcaktuara në Planin GE-06 dhe për këtë arsye kërkohet koordinimi me vendet që ndodhen brenda kësaj sipërfaqe. Plani GE06 përcakton një metodologji për identifikimin e administratave të prekura, e cila bazohet në parametrat e parashikuara të rrjetit që do të përdoren pas modifikimit. Gjithashtu, duke marrë parasysh se detajet e funksionimit të stacioneve të prekura potencialisht janë të panjohura, metodologjia i referohet parametrave për rastin më të keq të rrugëve të përhapjes dhe të parametrave të sistemit të stacioneve të panjohura marrëse.

Metodologjia lejon përcaktimin e distancës për secilin azimuth rreth stacionit të ri të propozuar ose të modifikuar, ose zonën brenda së cilës ndodhet stacioni, përtej të cilit forca e fushës interferuese pritet të jetë më pak se një vlerë specifike. Kur kjo distancë përcaktohet për secilin azimuth, përcaktohet një kontur i forcës së fushës, të quajtur konturi i koordinimit, i cili rrethon zonën e koordinimit.

Për të identifikuar administratat e prekura potencialisht nga një modifikim i propozuar në Plan, është e nevojshme të identifikohet niveli përkatës i forcës së fushës që do të përdoret në llogaritje. Përcaktimi i forcës së fushës bëhet brenda intervalit të frekuencave të Planit për largësi nga stacioni transmetues që do modifikohet deri në 1000 km me përqindje të kohës nga 1 deri në 50% dhe për lartësi të ndryshme të antenës së transmetimit. Metodologjia i referohet një dallimi midis rrugëve të transmetimit si mbi tokë, dete të ftohtë apo dete të ngrohtë. Gjithashtu, siguron procedura për trajtimin e lartësive të antenave me efekt negativ dhe përhapjes në rrugë të ndryshme (d.m.th. me kombinime të tokës dhe detit). Për qëllime të GE06, lartësitë e antenave transmetuese tokësore nuk janë më të larta se 3000 m.

Për të identifikuar ndonjë shërbim të prekur potencialisht merren në konsideratë të gjitha vendet, kufijtë e të cilëve ndodhen brenda ose kryqëzohen me konturin 1000 km. Vlera kritike e forcës së fushës të koordinimit është niveli i forcës së fushës, i cili, kur tejkalohet, përcakton që kërkohet koordinim. Krijohet një kontur për secilën interval frekuence bazuar në vlerën kritike korresponduese të koordinimit të shërbimit të transmetimit video që do të mbrohet nga modifikimi i Planit. Më pas zgjidhen caktimet frekuencore për të cilat vlerat korresponduese kritike duhet të nxirren nga tabelat e vlerave limit në Shtojcën 1 të Marrëveshjes.

Për secilën vlerë kritike limit vendoset një kontur koordinimi. Si rezultat do të ketë për secilin interval frekuencash, disa konture të mundshme koordinimi për çdo lloj shërbimi të konsideruar të prekur nga modifikimi.

Analiza finalizohet nga llogaritjet e sakta të intensitetit të fushës në kufijtë kombëtarë të vendeve të identifikuara.

Kur njoftohet një caktim në një shërbim tjetër parësor, ndërtohen konturet e koordinimit për stacionet transmetuese bashkë me stacionet marrëse në vendet e specifikuar ose zonave të shërbimit. Më i madhi i të dyve është për t'u marrë parasysh për identifikimin e administratave të ndikuara.

Ndërtimi i kontureve gjeometrike varet nga tipi i të dhënave të Planit Numerik. Për çdo tip të të dhënave të Planit Numerik përcaktohet një pikë reference. Nga kjo pikë reference zhvillohen prej 360 radiale me një çvendosje prej 1° duke filluar nga Veriu i Vërtetë. Pika ku radialët kryqëzohen me konturin ndërprerës të intensitetit të fushës dhe çdo kontur gjeometrik të shtrirë jashtë kufijve kombëtar të administratave njoftuese është vendosja e pikave të llogaritjes. Në këtë Aneks, procedurat përcaktojnë për çdo hap një gradë në azimuth rreth koordinimit të stacionit transmetues ose stacionit në një shërbim tjetër tokësor, distancën në të cilën intensiteti i fushës është arritur dhe kështu distancën e përdorur për të krijuar konturin e koordinimit. Të gjitha llogaritjet e intensitetit të fushës janë bazuar në modelin e përhapjes të përshkruar në Kapitullin 2 të Aneksit 2 në këtë Marrëveshje.



FIGURA 4: KONTURET E KOORDINIMIT ME ADMINISTRATAT E NDIKUARA ([ama.gov.al](http://ama.gov.al))

Në vijim përshkruhen supozimet bazë të bëra për llogaritjen e interferencave dhe vendosjen e pikës së referencës të përdorur për ndërtimin e kontureve të koordinimit.

Për një stacion transmetues që operon në një rrjet me frekuencë të vetme (SFN), konturet e koordinimit janë llogaritur duke përdorur si pikë reference qendrën e gravitetit të koordinatave

gjeografike të të gjithë vendndodhjeve të transmetuesve në SFN. Kontributet individuale të intensitetit të fushës të transmetuesave janë kombinuar nëpërmjet metodës së shumës së fuqisë (shih Kapitullin 3 të Aneksit 2 tek Marrëveshja).

Në rastin e një allotmenti, pika e referencës është qendra e gravitetit të zonës së mbuluar nga allotmenti, e cila mund të jetë e vendosur brenda ose jashtë kësaj zone mbulimi. Në rastin e dytë, pika e referencës merret sa më afër pikës së qendrës së gravitetit që përfshihet në zonën e allotmentit. Karakteristikat e referencës së rrjetit (RN) dhe plani i konfigurimit të referencës (RPC) janë referenca kryesore për përcaktimin e intensitetit interferues të fushës. Çdo pikë testuese në kufi të allotmentit do të konsiderohet si burim i interferencës potenciale të allotmentit (shih Paragrafin 3 në këtë Seksion për përshkrimet e detajuara). Intensiteti më i madh i fushës i arritur në çdo pikë llogaritjeje të marrë në konsideratë, nga çdo pikë testuese në kufi të allotmentit konsiderohet si vlera e intensitetit të fushës që do të përdoret.




FIGURA 5: MASKA E SPEKTRIT DVB-T PËR GJERËSINË E BREZIT 8 MHz (PLANI GE-06)

Kanalet 8 MHz		
	Rastet jo-kritike	Rastet sensitive
Frekuenca Relative (MHz)	Niveli Relativ (dB)	Niveli Relativ (dB)
-12	-110	-120
-6	-85	-95
-4.2	-73	-83
-3.9	-32.8	-32.8
+3.9	-32.8	-32.8
+4.2	-73	-83
+6	-85	-95
+12	-110	-120

**TABELA 5: KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË MASKËS SË SPEKTRIT DVB-T PËR GJERËSINË E BREZIT 8 MHz (PLANI GE-06)**

Marrëveshja GE-06 përcakton metodologjinë për të identifikuar administratat (zonat) që mund të preken, me të cilat duhet të kërkohet një marrëveshje. Metodologjia përcakton një zonë brenda së cilës tejkalohet kufijtë e forcës së fushës.

Procesi i identifikimit të administratave të prekura potencialisht bazohet në përcaktimin e kontureve të koordinimit të lidhura me modifikimet e propozuara.

Në rastin e këtij studimi, siç edhe u theksua më sipër, garantohet që modifikimet e bëra në plan nuk prekin administratat fqinjë, fuqitë e rrezatuara nga transmetuesit mbeten në të njëjtë vlerë.

## 2.8 KRITERET PËR PARAMETRAT E PLANIFIKIMIT DHE MODIFIKIMIT TË PLANIT GE-06

Modifikimi, ashtu si dhe hartimi i Planit GE-06, bazohet në respektimin e kriterëve për parametrat e mëposhtëm, të cilat kanë qënë objekt analize në këtë studim:

- fuqia minimale mesatare e fushës;
- fuqitë interferuese e fushës;

Përcaktuar bazuar në vlerat e kërkuara për:

- raportet Sinjal/Zhurmë ( $C/N$ );
- raportet e mbrojtjes;
- humbjet në hyrjen e ndërtesave;
- faktorët e korigjimit të vendndodhjes dhe kohës në përqindje;
- kufizimet e maskës së spektrit të zbatuar në një transmetim numerik.

### 2.8.1 MODELET E KANALEVE

Për të verifikuar performancën në një gamë të gjerë të kushteve të marrjes së sinjalit duke përfshirë marrjen fikse, portabël, celulare, janë përdorur modele të ndryshme kanali për të siguruar rezultate të simuluar të performancës.

Kanalet kryesore të marrjes së sinjalit që hasen në transmetimet tokësore kërkojnë një C/N të caktuar.

- Kanali Gaussian (AWGN): Ky kanal karakterizohet nga një sinjal i vetëm i kërkuar ku vetëm zhurma Gaussian është e pranishme.
- Kanali Ricean: Përdoret për marrjen fikse ku ka kryesisht një sinjal të vetëm të drejtpërdrejtë dhe reflektime më të vogla të amplitudës.
- Kanali Rayleigh: Kryesisht përdoret për planifikimin e marrjes portative të brendshme dhe të jashtme.

Ky punim trajton vetëm zbatimin e teknologjisë DVB-T2 në rrjetet fikse dhe, për këtë arsye, trajtohet modeli i kanalit Ricean.

### 2.8.2 RAPORTI C/N

Për variante të ndryshme sistemi Tabela 6 përcakton vlerat e raportit C/N për kanalën Ricean .

Diferenca në C/N e kërkuar për kanalën Ricean është 0.2 deri 0.5 dB kur krahasohet me kanalet Gaussian.

Variantet e sistemit	Modulimi	Shkalla e kodit	Gauss	Rice
				<b>FX</b>
A1, D1	QPSK	1/2	4.9	5.9
A2, D2	QPSK	2/3	6.8	7.9
A3, D3	QPSK	3/4	7.9	9.1
A5, D5	QPSK	5/6	9.0	10.3
A7, D7	QPSK	7/8	9.9	11.3
B1, E1	16-QAM	1/2	10.6	11.6
B2, E2	16-QAM	2/3	13.0	14.1
B3, E3	16-QAM	3/4	14.5	15.7
B5, E5	16-QAM	5/6	15.6	16.9
B7, E7	16-QAM	7/8	16.1	17.5
C1, F1	64-QAM	1/2	16.2	17.2
C2, F2	64-QAM	2/3	18.4	19.5
C3, F3	64-QAM	3/4	20.0	21.2
C5, F5	64-QAM	5/6	21.4	22.7
C7, F7	64-QAM	7/8	22.3	23.7

TABELA 6: VLERAT C/N PËR KANALET GAUSSIAN DHE KANALET RICEAN

Nga tabela e mësipërme shihet se në SFN-të egzistuese të Tiranë dhe Fierit, ku aplikohet modulimi 64 QAM dhe shkalla e kodit 3/4, vlera C/N është 21.2 dB. Qëllimi i këtij punimi është që zgjerimi i madhësisë SFN me rrjetin DVB-T2 do të ruaj apo të përmirësojë performancën e rrjetit si në këndvështimin e kapacitetit ashtu dhe të cilësisë së transmetimit.

### 2.8.3 RAPORTET E MBROJTJES

Raporti i mbrojtjes, i shprehur zakonisht në decibel, është vlera minimale e raportit të sinjalit të kërkuar ndaj atij të padëshiruar të shkaktuar nga interferues të jashtëm në hyrjen e marrësit. Ato mbulojnë raportet mbrojtjes “intra” (DVB-T2 vs. DVB-T2) dhe raportet mbrojtëse “inter” (DVB-T2 kundrejt sistemeve të tjera radio jo-T2, televiziv si dhe jo-televiziv), brenda-kanalit si dhe raportet e mbrojtjes së kanalit me kanalet fqinjë. Raportet e mbrojtjes të trajtuara në këtë punim janë të vlefshme për gjerësinë e brezit 8 MHz. Ato vlejné edhe për gjerësitë e brezit 1.7, 5, 6 dhe 7 MHz.

Për përcaktimin e raporteve të mbrojtjes për DVB-T është marrë për bazë Rekomandimi ITU-R BT.1368-6.

## Raporti i mbrojtjes DVB-T2 kundrejt DVB-T2/DVB-T

- Raportet e mbrojtjes “intra” DVB-T2 (DVB-T2 kundrejt DVB-T2) për ndërhyrjet brenda kanalit janë identike me vlerat përkatëse të C/N. E njëjta gjë vlen për raportet e mbrojtjes DVB-T kundrejt DVB-T2.
- Raportet e mbrojtjes së kanaleve fqinjë jepen në ITU-R Rec. BT.2033.
- Në modelin e zgjeruar të gjerësisë së brezit së DVB-T2 ka një rritje prej vetëm 0.2 në 0.3 dB e cila duket një ndryshim i papërfillshëm.
- Për raportet e mbrojtjes së T-DAB të ndërhyrë nga DVB-T2 supozohet se vlejnjë të njëjtat vlera siç raportohen për ndërhyrjen nga DVB-T. Këto gjenden në [RRC06].

## DVB-T2 kundrejt LTE

Interferenca e DVB-T2 në LTE konsiderohet e rëndësishme për arsye të operimit në kanale të njëjtë apo fqinjë.

- Lidhur me intreferencen në të njëjtin kanal “co-channel” asnjë informacion nuk është në dispozicion.
- Rasti i interferencës në kanalën fqinjë të DVB-T2 nga LTE merret në kontekstin e diskutimit të dividentit digjital në Evropë [ECC148]. Ngarkesat e ulta të trafikut shkaktojnë degradime në raportet e mbrojtjes dhe pragjet e mbingarkesës në disa dizajne të marrësve. Përsëri, informacioni gjendet në [BT2033]. Karakteristikat e sinjalit LTE të përdorura në matje janë dhënë në Raportin ITU-R BT.2215 [BT2215].

### 2.8.4 HUMBJA NË HYRJEN E GODINËS

Tabela 7 përmban vlerat mesatare për humbjen në hyrjen e godinës dhe devijimin përkatës nga standardi në UHF.

	Humbja në Hyrje të Godinës	Devijimi standart
UHF	8 dB	5.5 dB

TABELA 7: HUMBJA NË HYRJE TË GODINËS

### 2.8.5 NIVELET MINIMALE TË SINJALIT PËR SISTEMET E TRANSMETIMIT DIGJITAL

Forcat e fushës që përftohen nën kriteret, si më poshtë:

- Lartësia e antenës marrëse: 10 m mbi nivelin e tokës



- Probabiliteti i vendndodhjes: 50%
- Përqindja në kohë: 50%

cilësohen si "minimum mesatar i forcës të fushës", simbolizuar me  $E_{med}$ . Këto forca të fushës korrespondojnë me nivelet minimale të sinjalit të nevojshëm për të kapërcyer zhurmën natyrore dhe të prodhuar nga njeriu (në mungesë të interferencës nga transmetuesit e tjerë) të njohur edhe si "forcat minimale të shfrytëzueshme të fushës".

Minimumi i mesatares së forcës së fushës llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$P_n = F + 10 \log_{10}(kT_0B)$$

$$P_{s \min} = C/N + P_n$$

$$A_a = G + 10 \log_{10}(1.64x\lambda^2/4\pi)$$

$$\varphi_{\min} = P_{s \min} - A_a + L_f$$

$$E_{\min} = \varphi_{\min} + 120 + 10 \log_{10}(120\mu) = \varphi_{\min} + 145.8$$

$$E_{med} = E_{\min} + P_{mmn} + C_l \quad \text{për}$$

marrjen fikse

$$C_l = \mu * \sigma_c$$

$$\sigma_c = \sqrt{\sigma_b^2 + \sigma_m^2}$$

Ku:

$P_n$ : fuqia e zhurmës në hyrje të marrësit (dBW)

$F$ : figura e zhurmës në marrës (dB)

$k$ : konstantja e Boltzmannit ( $k = 1.38 \times 10^{-23}$  J/K)

$T_0$ : temperature absolute ( $T_0 = 290$  K)

$B$ : gjerësia e brezit të zhurmës në marrës ( $7.61 \times 10^6$  për një kanal 8MHz DVB-T)

$P_{s \min}$ : fuqia minimale në hyrje të marrësit

C/N: raporti sinjal/zhurmë RF në hyrje të marrësit e kërkuar nga sistemi

$A_a$ : hapja efektive e antenës

$G$ : fitimi i antenës në lidhje me gjysëm dipol (dBW/m<sup>2</sup>)

$\lambda$ : gjatësia e valës së sinjalit (m)

$\varphi_{\min}$ : fluksi i densitetit të fuqisë minimale në pikën e marrjes

$L_f$ : humja e feeder (dB)

$E_{\min}$ : forca minimale e fushës në vendndodhjen e antenës marrëse (dB ( $\mu$  V / m))

$E_{med}$ : minimum i forca mesatare e fushës (dB ( $\mu$  V / m))

$P_{mmn}$ : lejimi i zhurmës së krijuar nga njeriu (dB)

$L_h$ : faktori i korigjimit të humbjes së lartësisë (vendndodhja e antenës marrëse në 1.5 m mbi nivelin e tokës) (dB)

$L_b$ : humbja mesatare e hyrjes në ndërtesë (dB)

$Cl$ : faktori i korigjimit të vendndodhjes (dB)

$c$ : devijimi standard i kombinuar (dB)

$m$ : standardi makro-shkallë i devijimit (dB) ( $\sigma_m = 5.5$  dB)

$b$ : humbja e devijimit standard për hyrjen në ndërtesë (dB)

$\mu$ : faktori i shpërndarjes (0.52 për 70%, 1.64 për 95% dhe 2.33 për 99%).

### 2.8.6 INTENSITETI I FUSHËS TË SINJALIT TË PRANUESHME TË INTERFERENCËS

Intensiteti i fushës,  $E$ , për interferencën e pranueshme të sinjalit televiziv për rastet e shërbimeve fikse llogaritet duke përdorur formulën:

$$E = -37 + F - G_i + L_F + 10 \log (B_i) + P_o + 20 \log f - K \text{ dB}(\mu\text{V/m})$$

ku:

$F$ : zhurma e marrësit

$B_i$ : gjerësia e brezit të stacionit transmetues tokësor (MHz)

$G_i$ : amplifikimi i antenës marrëse (dBi)

$L_F$ : humbja e kabllit fider të antenës (dB)

$f$ : frekuenca qendrore e stacionit interferues (MHz)

$P_o$ : zhurma e ambientit (dB) (vlera tipike është 0 dB për brezin UHF)

$K$ : Faktori i korigjimit të mbivendosjes (në DVB-T).

Rekomandimi ITU-R F.758-4, ITU-R F.1670-1 dhe ITU-R SM.851-1, përcakton vlerat si në Tabelën 8 për  $F$ ,  $G_i$ ,  $L_F$  dhe  $P_o$  për rastin e shërbimeve fikse:

Frekuenca (MHz)	174-230	500	800
$F$ (dB)	5	5	5
$G_i$ (dBi)	9	14	16
$L_F$ (dB)	4	5	5
$P_o$ (dB)	1	0	0
$F - G + L_F + P_o$	1	-4	-6

TABELA 8:  $F$ ,  $G_i$ ,  $L_F$ ,  $P_0$  PËR RASTIN E SHËRBIMEVE FIKSE

Në brezin UHF, ndryshimet e  $(F - G + L_F + P_o)$  në frekuencën relative 500 MHz përcaktohen duke përdorur formulën:  $10 \log (f/500)$ .

Për llogaritjet e interferencës në marrësin e interferuar merret në konsideratë edhe koeficienti i mbivendosjes së korigjimit  $K$  (dB). Koeficienti i mbivendosjes,  $K$ , është llogaritur duke patur parasysh pikën e thyerjes së maskës (Kapitulli 3, Aneksi 2, Marrëveshja GE 06).

Koeficienti i mbivendosjes  $K$  ndërvaret nga mbivendosja e gjerësisë së brezit  $B_o$ , i llogaritur si me poshtë:

$$B_o = \text{Min} (B_v, (B_v + B_i)/2 - \square f)$$

ku:

$B_v$ : gjerësia e brezit të marrësit të interferuar

$B_i$ : gjerësia e brezit të sinjalit interferues


$\square f$ : ndryshimi ndërmjet qendrës së frekuencës së sistemit të shërbimit fiks dhe qendrës së frekuencës DVB-T interferuese.

Gjerësia e brezit të mbivendosur, $B_o$	Koeficienti i mbivendosjes, $K$ (dB)
$B_o = B_v$	0
$B_v > B_o > 10^{-4} B_v$	$10 \log_{10} (B_o/B_v)$
$10^{-4} B_v > B_o > -0.5$	-40
$B_o = -1$	-45
$B_o = -2$	-52
$B_o = -4$	-60
$B_o = -8$	-77

TABELA 9: RASTET JO-KRITIKE PËR MASKËN DVB-T

Gjerësia e brezit e mbivendosur, $B_o$	Koeficienti i mbivendosjes, $K$ (dB)
$B_o = B_v$	0
$B_v > B_o > 10^{-5} B_v$	$10 \log_{10} (B_o/B_v)$
$10^{-5} B_v > B_o > -0.5$	-50
$B_o = -1$	-55
$B_o = -2$	-62
$B_o = -4$	-70
$B_o = -8$	-87

TABELA 10: RASTET SENSITIVE PËR MASKËN DVB-T



$F_w$ : qendra e frekuencës së sinjalit të dëshiruar

$F_l$ : qendra e frekuencës së sinjalit interferues

TABELA 11:  $B_o, B_l, B_v$

## 2.8.7 FAKTORËT E KORIGJIMIT TË VENDNDODHJES

Saktësia e modelit të parashikimit të përhapjes mund të përmirësohet me aplikimin e një numri faktorësh korigjimi.

Për shkak të degradimit të mprehtë të cilësisë që ndodh kur nuk arrihet raporti i kërkuar bartës-interferencë ose raporti i kërkuar zë-zhurmë, kërkohet një përqindje më e lartë e probabilitetit të vendndodhjes për forcat e kërkuara të fushës (dhe përqindje më e ulët për sinjalet e interferuara). Prandaj, kërkohet një korigjim i vlerës së marrë të quajtur faktor i korigjimit të vendndodhjes.

Llogaritjet e përputhshmërisë për sistemet e transmetimit numerik bazohen në kurbat e përhapjes për 50% kohë për forcën e kërkuar të fushës në terren, dhe 1% për forcën e padëshiruar të fushës, siç janë dhënë në Kapitullin 2 të Shtojcës 2 të Marrëveshjes GE-06.

Rekomandimi ITU-R P.1546 jep një shkallë standarde devijimi makro prej 5.5 dB për sinjalet me brez të gjerë. Kjo vlerë do të përdoret për të përcaktuar ndryshimin e forcës së fushës në “outdoor”, e cila merret parasysh në kuptimin e "faktorit të korigjimit të vendndodhjes".

Faktorët e korigjimit të vendndodhjes për ndryshimet në shkallë makro janë dhënë në Tabelën 12.

Objektivi i mbulimit Propabiliteti i mbulimit (%)	Faktori i korigjimit të vendodhjes (VHF and UHF) (dB)
99	13
95	9
70	3

TABELA 12: FAKTORI I KORIGJIMIT TË VENDNDODHJES “OUTDOOR” (ITU-R P.1546)

Ndryshimet e forcës së fushës në “indoor” janë rezultati i kombinuar i ndryshimeve “outdoor” dhe ndryshimit për shkak të shuarjeve nga ndërtesat. Për UHF, ku të dy devijimet standarde të sinjalit janë 5.5 dB, vlera e kombinuar është 7.8 dB.

Faktori i korigjimit të vendndodhjes për ndryshimet në shkallë makro në vendndodhjet “indoor” jepen në Tabelën 13.

Objektivi i mbulimit Propabiliteti i mbulimit (%)	Faktori i korigjimit të vendodhjes (UHF) (dB)
95	13
70	4

TABELA 13: FAKTORI I KORIGJIMIT TË VENDNDODHJES “INDOOR” (ITU-R P.1546)

### 2.8.8 KONFIGURIMET E REFERENCAVE TË PLANIFIKIMIT PËR DVB-T

Konfigurimet e Referencave të Planifikimit (RPC) janë struktura rrjeti që përfaqësojnë një rrjet tipik të vërtetë për qëllime analize dhe përshtatshmërie. Qëllimi kryesor i përdorimit të Konfigurimeve Referencë të Planifikimit është përcaktimi i potencialit për ndjeshmërinë kundrejt interferencave në rrjetet tipike të transmetueve numerike.

Për të përcaktuar konfigurimin e referencës të planifikimit (RPC) për DVB-T, konfigurimet e planifikimit mund të grupohen sipas mënyrës së marrjes së sinjalit dhe brezit të frekuencave.

Konfigurimet e Referencave të Planifikimit bazuar në mënyrat e marrjes së sinjalit janë grupuar si më poshtë:

- RPC 1: RPC për marrje fikse;
- RPC 2: RPC për marrje portabël “outdoor” ose cilësi më të ulët të mbulimit të marrjes portabël ose të lëvizshme “indoor”;
- RPC 3: RPC për cilësi më të lartë të mbulimit për marrje të portabël ose të lëvizshme “indoor”.

Për DVB-T, Konfigurimi i Referencës së Planifikimit në UHF i referohet frekuencës 650 MHz, si në Tabelën 14.

RPC	RPC 1
Referenca e propabilitetit të vendodhjes	95%
Referenca e C/N (dB)	21
Referenca $(E_{med})_{ref}$ (dB( $\mu$ V/m)) në $f_r = 650$ MHz	56

TABELA 14: RPC1 PËR DVB-T (ITU-R P.1546)

$(E_{med})_{ref}$ : Vlera e referencës për minimumin mesatar të intesitetit të fushës

Për frekuencat e tjera, vlerat referencë të intensitetit të fushës rregullohen duke shtuar faktorin e korigjimit të përcaktuar sipas rregullit vijues:

$$-(E_{\text{med}})_{\text{ref}}(f) = (E_{\text{med}})_{\text{ref}}(f_r) + \text{Corr};$$

- për marrjen fikse,  $\text{Corr} = 20 \log_{10}(f/f_r)$ , ku  $f$  është frekuenca aktuale dhe  $f_r$  frekuenca refereruese e brezit përkatës (650 MHz);

Parametrat e referencës së RPC1 nuk i përkasin vetëm sistemit DVB-T ose një zbatimi real të tij, por vlejnë për një numër të madh implementimesh të ndryshme reale.

Devijimi standard i përdorur për llogaritjen e faktorit të korigjimit të vendndodhjes për RPC 1 do të jetë 5.5 dB në UHF.

## 2.8.9 RRJETET E REFERENCËS PËR DVB-T

Me qëllim përcaktimin e potencialit dhe ndjeshmërisë nga interferencat të rrjeteve tipike të transmetimit numerik, Plani GE-06 ka modeluar katër rrjete reference (RN) që përfaqësojnë 4 tipe të rrjeteve DVB-T.

1. *Rrjeti i referencës 1 (zonë e madhe e shërbimit SFN)*
2. *Rrjeti i referencës 2 (zonë e vogël e shërbimit, SFN i dendur)*
3. *Rrjeti i referencës 3 (zonë vogël e shërbimit SFN, zonë urbane)*
4. *Rrjeti i referencës 4 (zona e vogël e mbyllur e shërbimit SFN)*

Për rrjetet e referencës është zgjedhur një strukturë e hapur rrjeti duke marrë në konsideratë se zbatimet reale normalisht i ngjajnë një prej katër tipeve të rrjeteve. Për rastin në studim, zona e shërbimit përcaktohet si një gjashtëkëndësh rreth 15% më i madh se gjashtëkëndëshi i formuar nga transmetuesit periferikë. Sidoqoftë, për të lejuar zbatimin e rrjetit me potenciale shumë të ulëta për interferenca, është prezantuar gjithashtu një rrjet referencë me një strukturë rrjeti gjysëm të mbyllur.

Në disa raste, potencialet për interferenca në rrjetet e referencës i mbivlerësojnë ndjeshëm ato në zbatimin në rrjetin real, për shembull, kur gjeometria standarde e një rrjeti referimi ndryshon ndjeshëm nga forma e veçantë e zonës së shërbimit real. Në këto raste, administratat mund të përdorin një metodë të përshtatshme, të rënë dakord mbi baza bilaterale, për të modeluar më mirë potencialin e ndërhyrjes së rrjetit të referencës.





Ky lloj rrjeti konsiston në tre transmetues të vendosur në rrethin e një trekëndëshi barabrinjës. RN 2 është menduar për zona të vogla mbulimi SFN. Kjo zonë shërbimi ka një diametër që varion nga 30 deri në 50 km.

Aktualisht pikat e transmetimit në allotmentet aktualë të Tiranës dhe të Fierit respektojnë distancën me përafërsi nga 25-40 Km midis tyre. Në rastin kur bashkojmë dy allotmentet në një të vetëm, diametri i zonës së shërbimit merr përmasat 90-160 Km. Si pasojë e zgjerimit të zonës së shërbimit, rrjeti referues nga tipi RN2 kalon në tipin RN1. Të dhënat teknike të një rrjeti referues RN1 janë sipas tabelës më poshtë:




FIGURA 7: HAPËSIRA TË MËDHA MBULIMI SFN (RN 1)

RPC 1 Antena fikse	
Tipi i rrjetit	I hapur
Gjeometria e hapësirë së shërbimit	Gjashtëkëndor
Numri i transmetuesve	7
Gjeometria e rrjetit të transmetuesve	Trekëndor
Distanca ndërmjet transmetuesve $d$ (km)	70
Diametri i hapësirës së shërbimit $D$ (km)	161
Lartësia efektive e antenës Tx (m)	150
"Pattern" i antenës Tx	Jo-e drejtuar
e.r.p. (dBW)   Brezat IV/V	42.8

\*Vlera e e.r.p. e treguar në këtë tabelë përmban një shtesë fuqie prej 3 dB.

**TABELA 16: PARAMETRAT E RN1 (HAPËSIRA TË MËDHA MBULIMI SFN) (PLANI GE-06)**

Siç vihet re dhe nga tabela distanca midis pikave të transmetimit variojnë nga 40-70 Km. Si edhe në rastin e këtij studimi kalohet nga rrjeti referues me tre transmetuesa (alotmentet Tiranë dhe Fier) në një alotment me shtatë transmetues kryesorë (alotmenti Tiranë-Fier).

## KAPITULLI III

### RRJETET ME FREKUENCE TË VETME (SFN)

#### 3.1 TIPET E RRJETEVE

Për shfrytëzimin optimal të kapaciteteve të krijuara nga Plani Kombëtar i Frekuencave Numerike, secili alotment mbulohet nga një rrjet me frekuencë të vetme (SFN- single frequency network). Për krijimin e mbulimeve më të mëdha së një allotment kombinohen dy ose më shumë SFN. Për krijimin e një rrjeti kombëtar kërkohet kombinimi i SFN-ve të 11 allotmenteve, duke krijuar një rrjet MFN (multi frequency network).

Mundësia e ndërtimit të një SFN-je konsiderohet si një nga tiparet përcaktuese të transmetimit numerik. Kjo lejon një rritje të ndjeshme në efikasitetin e përdorimit të spektrit të radio frekuencave. Nga ana tjetër, SFN-të kanë avantazhin që zgjerimi i rrjetit dhe shtimi i transmetuesve shtesë (gap-fillers) mund të bëhet pa nevojën e riplanifikimit.

Një nga çështjet kryesore në lidhje me SFN-të është kërkesa për sinkronizim të transmetuesve që ndodhen larg njëri-tjetrit. SFN përdor një rrjet të transmetuesve të fuqisë së ulët me forcë të fushës më uniforme. Të gjithë transmetuesit sinkronizohen në mënyrë të përkryer, përdorin të njëjtën frekuencë dhe transmetojnë të njëjtën përmbajtje.




FIGURA 8: RRJETET SFN & MFN

Kalimi nga rrjeti MFN në një rrjet SFN ka një avantazh të padiskutueshëm që në rastin e këtij studimi është kursimi i 8 MHz të gjerësisë së brezit të liruuar. Përveç efikasitetit më të mirë të spektrit të përshkruar më lartë, SFN ka efikasitet më të mirë të energjisë. Energjia elektrike e konsumuar nga të gjithë transmetuesit e SFN-së do jetë më e ulët se në sistemin MFN me të njëjtën zonë mbulimi. Krahasuar me rrjetin MFN, SFN për transmetimin e të njëjtit sinjal në

të njëjtën hapësirë mbulimi përdor shumë transmetues dhe si rrjedhim reduktohet fuqia e tyre e transmetimit.

SFN-të kërkojnë kontroll të përqëndruar të frekuencës dhe kohës; sistemi global i pozicionimit (GPS) është më i përdorur për të siguruar një frekuencë të qëndrueshme dhe referencë kohore ndaj së cilës mund të menaxhohet sinkronizimi i kohës së rrjetit. Dështimi në sinkronizim në çdo pjesë të rrjetit ose një shmangie në frekuencën e një transmetuesi mund të rezultojë në interferenca të forta.

Në një MFN rajonale, nuk ndodh që të gjitha frekuencat e transmetuesve të influencohen në të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë. Diversiteti i frekuencave në një MFN zbut sadopak interferencën. Në një SFN të madhe, nuk ekziston një diversitet i tillë i frekuencës dhe si pasojë interferenca, kur ndodh, në një moment të caktuar, mund të ndikojë në zona më të mëdha sesa do të ndikoheshin në një MFN.

Në kalimin nga një rrjet MFN në një rrjet SFN, si në rastin e studiuar në këtë punim, duhet të vlerësohet me kujdes intervali i mbrojtjes për të menaxhuar të gjitha jehonat e simboleve që arrijnë marrësin. Nëse të gjitha sinjalet e vonuara (ekot i simbolit) vijnë tek marrësi brenda intervaleve të mbrojtjes, është e mundur të përpunohen sinjalet në mënyrë inteligjente për të shmangur shuarjet apo deformimet. Ky është elementi më i rëndësishëm për projektimin e rrjetit të frekuencave të vetme (SFN).

Në mënyrë të përgjithshme si më poshtë përmbledhen avantazhet dhe disavantazhet e një rrjeti SFN kundrejt rrjetit MFN.

	<i>Avantazhet</i>	<i>Disavantazhet</i>
<i>SFN</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Eficiencë e shkëlqyer spektrale</li> <li>➤ Eficiencë e lartë e përdorimit të energjisë elektrike)</li> <li>➤ Marrje e kënaqshme e sinjalit në mjediset e brendshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ndarja e rrjeteve për përmbajtje lokale e vështirë</li> <li>➤ Kosto shtesë për sinkronizim</li> <li>➤ Kosto shtesë për mbrojtjen nga vetë-interferenca.</li> </ul>
<i>MFN</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Bashkekzistenca me kanalet analoge</li> <li>➤ Nuk ka kufizime për ofrimin e programeve rajonale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përdorim jo efektiv i spektrit (edhe pse shumë më mirë se në analog)</li> <li>➤ Jo shumë i favorshëm për DVB-H</li> <li>➤ Nuk ka mbulim të mirë në mjediset e brendshme</li> <li>➤ Eficencë më e ulët e përdorimit të energjisë elektrike</li> </ul>

**TABELA 17: AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E RRJETEVE SFN DHE MFN**

Duke krahasuar rrjetet e ndryshme dhe duke marrë në konsideratë tre parametrat si mbulimi, kanalet e frekuencave dhe kapaciteti i transmetimit, është konstatuar se SFN-të rajonale janë rreth 10% më efikente se MFN-të, ndërsa SFN-të kombëtare janë rreth 15% më efikente. Nëse krahasimi i efikasitetit bëhet në aspektin e numrit të programeve që mund të transmetohen me konfigurime të ndryshme të rrjetit përsëri arrihet në të njëjtat përfundime.

Ndërkohë, rritja e madhe e hapësirave të mbulimit të një SFN-je, ku efienca e përdorimit të spektrit rritet, kufizohet nga disavantazhet e mëposhtme:

- SFN-të e mëdha, për shkak të rrezes së tyre të mbulimit, kërkojnë një interval më të gjatë mbrojtje dhe, për këtë arsye, kapaciteti i transmetimit për multiplekser zvogëlohet ndjeshëm.
- SFN-të e mëdha janë shumë më pak praktike për shpërndarjen e përmbajtjes rajonale. SFN mund të përdoren në një larmi zonash mbulimi. Në mënyrë tipike, ato përdoren për mbulim kombëtar ose rajonalë, por mund të përdoren për zona më të vogla lokale (madje edhe në nivelin e një qyteti të vetëm).

### 3.2 RRJETET SFN

Transmetuesit brenda një SFN-je nuk mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur - përmbajtja që ata transmetojnë duhet të jetë identike, dhe koha në të cilën ata transmetojnë duhet të kontrollohet saktësisht. Sinjalet e transmetuara nga stacionet brenda një SFN duhet:

- të jenë sinkronizuar saktësisht në kohë;
- të transmetojnë në një kanal frekuencë;
- të transmetojnë përmbajtje identike.

Këto kërkesa rrisin kompleksitetin në rrjet. +

Për një e.r.p. të caktuar mund të hasen tre regjime të ndryshme të sjelljes për çdo skenar të veçantë të kombinimit  $h_{eff}$ , ISD, GI, C/N. Në regjimin e parë, e.r.p.-të e transmetuesit është shumë e ulët për të mbuluar të gjithë zonën e shërbimit. Kjo mund të kapërcehet duke shtuar përsëritësa. Në regjimin e dytë, niveli i vetë-interferencës në SFN është aq i lartë sa që nuk mund të arrihet mbulimi i plotë. Kjo nuk mund të kapërcehet nga një ndryshim (rritje ose ulje) i e.r.p.-së. Nëse gjendet një kombinim i të dy rasteve, mbizotëron e dyta. Në regjimin e tretë konsiderohen rastet kur degradimi vet-interferencës (SI) mund të zbutet nga rregullimi i karakteristikave individuale të transmetuesve si p.sh. vonesa kohore statike, sic edhe do të trajtohet me poshtë. Në këtë studim janë aplikuar regjimi i parë dhe i tretë.

SFN-të mund të kategorizohen si të hapura ose të mbyllura:

Në një rrjet të hapur, nuk merren masa për të minimizuar nivelin e rrezatimit drejt zonave jashtë zonës së mbulimit. Ka raste, edhe pse të rralla, ku një rrjet i hapur mund të përbëhet nga një transmetues i vetëm.

Në një rrjet të mbyllur, niveli i rrezatimit drejt zonave jashtë zonës së mbulimit zvogëlohet duke ruajtur përqindjen e mbulimit brenda zonës së shërbyer. Kjo mund të bëhet duke përdorur antena të drejtuara në stacionet transmetuese në periferi të zonës së mbulimit.

Megjithëse një SFN mendohet si një rrjet relativisht homogjen me të gjithë transmetuesit që kanë të njëjtën lartësi dhe e.r.p., në praktikë, shumë SFN ndërtohen duke përdorur një përzierje të transmetuesve të energjisë së lartë, të mesme dhe të ulët me e.r.p. që variojnë nga 10 kW deri në 50 W.

Në një rrjet real, që mbulon një zonë të madhe mund të ketë distanca të konsiderueshme ndërmjet transmetuesve. Nëse një rrjet i tillë është projektuar si një rrjet i mbyllur, kjo do të shkaktojë më pak ndërhyrje në një distancë të caktuar jashtë zonës së tij të mbulimit sesa po të ishte projektuar si një rrjet i hapur. Arsyeja për këtë është se niveli i interferencave përcaktohet kryesisht nga fuqia e rrezatuar nga transmetuesit më afër kufirit të zonës së mbulimit. Sidoqoftë, në një rrjet të mbyllur që mbulon një zonë të vogël, fuqia e rrezatuar nga transmetuesit kontribuon relativisht më shumë në nivelin e ndërhyrjes dalëse sesa në një rrjet të mbyllur që mbulon një zonë të madhe. Si rrjedhim, për zonat relativisht të mëdha të mbulimit, distanca e ndarjes midis zonave që shërbehen nga e njëjta frekuencë (co-channel) do të jetë përgjithësisht më e vogël për rrjetet e mbyllura sesa për ato të hapura. Për zonat më të vogla të mbulimit distanca e ndarjes për rrjetet e mbyllura afrohet me atë të rrjeteve të hapura.

Numri i stacioneve transmetuese dhe distancat e ndarjes midis tyre ndryshojnë shumë nga rrjeti në rrjet dhe varen nga varianti i sistemit, mënyra e marrjes së sinjalit (fikse, e lëvizshme ose e lëvizshme) dhe madhësia e zonës që do mbullohet.

Në një SFN distanca e ndarjes midis transmetuesve ndikon në madhësinë e intervalit mbrojtës, i cili nga ana tjetër përcakton madhësinë e rrjetit. Një rrjet i stacioneve me fuqi të ulët ose të mesme të vendosura afër, ofron disa përparësi krahasuar me rrjetet e bazuara në transmetues të energjisë së lartë të ndarë nga distanca të mëdha.

Për rastin e SFN-ve rajonale, mund të përdoren rrjete të dendura transmetuesish me e.r.p. konsiderueshëm më të vogël krahasuar me rastin kur një transmetues i vetëm i shërben gjithë zonës së mbulimit. Për transmetimin digjital tokësor, koncepti i "emetimit të shpërndarë" në një SFN nënkupton ofrimin e forcës së kërkuar të fushës në të gjithë zonën e shërbimit nga një numër transmetuesish të energjisë së ulët, të sinkronizuar ose një numër përsëritësash që marrin sinjalin nga transmetuesi kryesor për të përmirësuar mbulimin e tij. Në rastin e fundit,

implementuar dhe në kë punim, përsëritësit sinkronizohen në kohë dhe nuk nevojitet asnjë infrastrukturë paralele e shpërndarjes për t'u sjellë sinjalin.

Gjithashtu, SFN-të lokale me densitet të lartë mund të përdoren për të plotësuar SFN të madhe në zonat ku mbulimi bëhet i pamundur për shkaqe të ndryshme si për shembull topografisë.

Së fundi, zvogëlimi i ndikimit të interferencave bashkë-kanale përtej kufirit të zonës së shërbimit mund të realizohet nëpërmjet direktivitetit të antenës transmetuese. Për shembull, mund të parashikohen topologji të tilla të rrjetit, në të cilat pjesa qendrore e zonës së shërbimit është e mbuluar nga një SFN i madh me transmetues të energjisë së lartë të ndarë nga distanca të mëdha, por afër kufirit të zonës së mbulimit instalohet një rrjet i dendur transmetuesish me e.r.p. të vogël dhe me antena me lartësi të ulët dhe të drejtuara. Kjo lejon reduktimin e ndërhyrjeve në zonat fqinjë dhe ruajtje të nivelit të kërkuar të shërbimit brenda zonës së mbulimit.

Antenat transmetuese mund të kenë modelin omni-direksionale ose të drejtuara. Për stacionet e vendosura afër kufirit të një zone të mbulimit SFN, antenat e drejtuara mund të përdoren për të zvogëluar ndërhyrjet jashtë zonës së mbulimit, duke zvogëluar kështu distancën e ndarjes për frekuencat në fjalë dhe për të mbrojtur zonat e mbulimit të shërbimeve të tjera ekzistuese. Kjo është veçanërisht e vërtetë për stacionet me fuqi të mesme dhe të lartë.

Pjerrësia e antenës është një mjet efikas për të mos lejuar fuqinë e rrezatuar të stacioneve të fuqisë së lartë në pjesën e jashtme të zonës së mbulimit dhe, në të njëjtën kohë, për të zvogëluar potencialin e ndërhyrjeve në distanca të mëdha dhe për shërbimet e tjera të radios.

Zonat e mbulimit të shërbyera nga transmetuesit e vendosur përgjatë kufirit të zonës së mbulimit dhe duke përdorur antena direktive të drejtuar nga brenda zonës së mbulimit (domethënë, në një rrjet të mbyllur) do të rezultojnë në distanca më të shkurtra të ripërdorimit të frekuencave krahasuar me mbulimin ekuivalent të arritur nga përdorimi i antenave jo-të drejtuara (domethënë, në një të hapur rrjeti). Në rastin kur rrugët e përhapjes së sinjalit janë në pjesën më të madhe det, distancat e ripërdorimit të frekuencave është më e madhe sesa për rastin e rrugëve tokësore.

DVB-T2, në krahasim me paraardhësin e tij DVB-T, ka futur dukshëm më shumë fleksibilitet në planifikimin dhe implementimin e një rrjeti SFN. Në veçanti, kohëzgjatjet në rritje të intervalit mbrojtës që ofron DVB-T2 lejojnë që madhësia maksimale praktike e SFN të zgjatet duke ruajtur shpjetësinë e transmetimit (ose anasjelltas, shpejtësia e transmetimit të SFN-së ekzistuese të rritet ndërkohë që ruhet mbulimi). Në rastin e parë, duhet vlerësuar sa është shtrirja maksimale e mundshme e një SFN, a ka ndonjë kufizim në zonën gjeografike që një SFN mbulon.

Masia e zgjerimit të zonave të mbulimit të SFN-së në praktikë kufizohet nga një numër faktorësh teknikë dhe jo-teknikë. Vetë-interferenca vendos kufizimin kryesor në madhësinë e një SFN-je. Në terma të gjerë, një SFN do të përmbajë zona të errëta mbulimi nëse transmetuesit ndahet nga distanca që tejkalojnë intervalin e mbrojtjes. Mbulimi mund të rifitohet duke rritur intervalin e mbrojtjes së sinjalit ose duke përmirësuar qëndrueshmërinë e tij. Sidoqoftë, realizimi i secilës prej këtyre opsioneve ndikon në uljen e shpejtësisë e transmetimit të rrjetit. Si rrjedhim është e rëndësishme të gjendet kombinimi më i kënaqshëm i tyre. Gjithashtu, rritja e numrit të stacioneve brenda rrjetit në mënyrë që të zvogëlohet distanca ndërfaqe (ISD) do të kapërcente vetë-interferencën pa prekur mbulimin ose kapacitetin e transmetimit. Por, ky option nuk është i dëshirueshëm jo vetëm për koston e lartë por edhe për faktin që mund të jetë arsye për të shkaktuar interferenca të jashtme. Eksperiencat kanë treguar shtimi i përsëritësve (gao-filler) është një rast i këshillueshëm për përmirësimin e mbulimit dhe reduktimit të interferencave. Faktorët shtesë jo-teknikë ndikojnë, gjithashtu, në përcaktimin e madhësisë së rrjetit SFN siç janë kërkesat për transmetimin programeve rajoneve sipas ndarjeve administrative. Kjo është arsyeja që zonat e mbulimit të rrjeteve SFN janë në përgjithësi të përshtatura me kufijtë e ndarjeve administrative.

Mbulimi dhe performanca e një SFN-je është një rezultat i përbashkët i parametrave të të gjithë transmetuesve në SFN. Për shkak të numrit të madh të parametrave të përfshirë në proces, gjetja e konfigurimit të duhur është mjaft kompleks. Duke ofruar më shumë mundësi të parametrave të sistemit sesa paraardhësi i tij DVB-T, DVB-T2 lejon rrjete më të mëdha SFN për të njëjtat parametra të sistemit. Sidoqoftë, vetë-interferenca në SFN krijon kufizime në distancën ndër-transmetuese dhe madhësinë e rrjetit. Në mënyrë që të bëhet përdorimi optimal i spektrit, e njëjta frekuencë ripërdoret në zona të ndryshme gjeografike - përtej distancës së ripërdorimit për të shmangur interferencat në kanal. Në këtë punim, është përdorur një metodologji e bazuar në modelet teorike të rrjetit. Një numër arkitekturash të rrjetit dhe modeleve të referencës së rrjetit janë marrë në konsideratë për marrjen fikse në mënyrë që të studiojmë efektet e parametrave të planifikimit në madhësinë SFN dhe distancën minimale të ripërdorimit. Shpejtësia e bitit, madhësia e rrjetit dhe distanca e ripërdorimit janë të lidhura ngushtë. Për më tepër, intervali mbrojtës nuk është i vetmi parametër kufizues dhe se ndikimi i tij varet fuqimisht nga pjesa tjetër e parametrave në DVB-T2 si dhe nga karakteristikat e rrjetit (Fuqia e rrezatuar ekuivalente, lartësia efektive, largësia ndër-transmetuesi), të cilat në rastin tonë mbeten të pandryshuara. Duke supozuar se kërkesat e C / N janë rreth 21 dB dhe bitrate mbi 30 Mbps, është konstatuar se një SFN mund të arrijë deri në përmasat 360 x 360 km për shpejtësi transmetimi 39.2 Mbps dhe 720 x 720 km shpejtësi transmetimi 37.5 Mbps. Distanca e ripërdorimit do të ketë gjithashtu një varësi komplekse nga mënyra DVB-T2 dhe veçanërisht nga parametrat e rrjetit, duke filluar nga nën 100 deri në 300 km. Megjithatë, skenarë bazuar në raste të tilla specifike të SFN nuk kanë zbatueshmëri praktike. Modelet teorike të SFN përfaqësojnë një mjet të dobishëm për të analizuar kufijtë e performancës së rrjeteve DVB-T2.



Për më tepër, topologjitë e ndryshme të rrjetit do të kërkojnë parametra të ndryshëm DVB-T2 dhe do të shfaqin kufij të ndryshëm të madhësisë së mbulimit dhe të distancave minimale të ripërdorimit.

Modelet teorike të SFN-ve janë përdorur edhe në këtë punim si një mjet për të përcaktuar konfigurimet optimale të planifikimit të rrjetit që përmbush kërkesat specifike. Këto konfigurime duhet të marrin në konsideratë marrëveshjet ndërkombëtare të koordinimit siç është GE-06.

Në rastin e këtij studimi, si për SFN-të egzistuese dhe për SFN-në e zgjeruar që mbulon dy alotmentet egzistuese, topologjia e shpërndarjes së transmetuesve i përket rrjetit të mbyllur me një mbrojtje të mirë nga ndërhyrjet (co-channel), me antena të drejtuara dhe transmetues te fuqive 10 kw dhe 50W.

### 3.3 FENOMENI ISI DHE VARIABLAT PËR SHMANGIEN E TIJ

Në transmetimin digjital, informacioni transmetohet përmes një numri të madh të bartësve, secila prej të cilave transporton sasi të vogla informacioni. Çdo pjesë e informacionit që transportohet nga një bartës modullohet në fazë dhe amplitudë dhe emërtohet simbol. Modulimi dhe demodulimi bëhen nëpërmjet Transformimit të Shpejtë të Anasjelltë të Furierit (IFFT) dhe Transformimit të shpejtë të Furierit (FFT). Marrësit demodulojnë sinjalin gjatë kohëzgjatjes së simbolit. Nëse shënojmë me  $n$  simbolin që dritarja FFT kërkon të demodulojë në një moment të caktuar, me  $n - 1$  dhe  $n + 1$  shënojmë simbolet paraardhëse dhe pasardhëse dhe në Figurën 9 tregohet pozicioni i dritares FFT me gjatësi të njëjtë me simbolin.




FIGURA 9: TRANSMETIMI SHUME-DREJTIMËSH

Sinjalet SFN vijnë nga transmetues të ndryshëm dhe përshkruajnë rrugë të ndryshme, duke arritur në kohë të ndryshme për marrësin. Ky fenomen e bën të vështirë sinkronizimin e saktë të gjitha sinjaleve.

Sinkronizimi i simbolit  $n$  që vjen me sinjalin e parë shkakton një mbivendosje të dritares FFT me simbolin e mëparshëm  $n - 1$  të sinjalit të vonuar (për shkak se vjen nga një transmetues më i largët apo rrugë më e gjatë). Meqenëse simbol  $n - 1$  mbart informacione të ndryshme nga simboli  $n$ , mbivendosja vepron si interferencë në simbolin  $n$ , që quhet interferencë inter simbol (ISI).




FIGURA 10: ISI ME NJË SINJAL TË VONUAR

Për të kapërcyer këtë interferencë ISI ndërfitet një interval kohor me gjatësi të caktuar në fillim të çdo simboli që emërtohet intervali i mbrojtjes dhe shënohet me  $\Delta$ .






FIGURA 11: RITJA E KOHËZGJATJES SË SIMBOLIT ME FUTJEN E GI

Kohëzgjatja origjinale e simbolit emërtohet kohëzgjatja e dobishme e simbolit  $T_u$ , ndërsa kohëzgjatja totale e simbolit mbasi shtohet dhe intervali i mbrojtjes emërtohet me  $T_s$ . Kohëzgjatja e dritares FFT gjatë së cilës vlerësohet simboli ruhet në vlerën origjinale  $T_u$  dhe ortogonaliteti nga OFDM realizohet, gjithashtu, me kohëzgjatjen origjinale të simbolit  $T_u$  dhe jo me kohëzgjatjen  $T_s$ . Intervali i mbrojtjes lejon që dritarja FFT të pozicionohet në mënyrë që të mos ketë mbivendosje ndërmjet simboleve që arrijnë në kohë të ndryshme, duke shmangur kështu ISI.

Por ndërfutja e intervalit të mbrojtjes okupon një pjesë të kohës së transmetimit të të dhënave "të dobishme" duke zvogëluar në këtë mënyrë kapacitetin e transmetimit. Ndërsa përqindja e simbolit që përdoret për intervalin e mbrojtjes rritet, shpejtësia e transmetimit të të dhënave zvogëlohet. Për të zgjidhur këtë problem, janë analizuar të gjithë faktorët e tjerë që ndikojnë në rritjen e hapësirës së mbulimit të rrjetit SFN me qëllim rritjen sa më pak të intervalit të mbrojtjes me kushtin që të shmanget interferenca ISI.

Nëse do të përdorej një sistem me një numër më të madh bartësish, kohëzgjatja e simbolit do të rritej dhe për të njëjtin proporcion të intervalit mbrojtës mbrojtja nga interferencat ISI do jetë më e mirë në terma të kohës absolute. Por, rritja e numrit të bartësve ka edhe disa pengesa: - kompleksitet më i lartë (FFT kryhet në një numër më të madh të kampioneve dhe kërkohet më shumë memorie) - ndjeshmëri më e lartë ndaj zhurmës së fazës së akorduesit. Megjithatë, këto disavantazhe konsiderohen të rëndësishëm sekondare krahasuar me rolin e përmasave FFT në rritjen e madhësisë së SFN-së.

Pozicionimi i dritares FFT përbën, gjithashtu, një element të rëndësishëm në shmangien e interferencave ISI. Kohëzgjatja e simbolit lejon një numër pozicionesh të ndryshme të mundshme të dritares FFT për vlerësimin e një simboli.

Përdorimi i një strategjie të përshtatshme sinkronizimi për pozicionimin e dritares të Transformimit të shpejtë Fourier (FFT) në anën e marrësit është një faktor i rëndësishëm që ndikon në zbutjen e interferencës ISI.





FIGURA 12: POZICIONE TË DRITARES FFT

Në varësi të vonesës nga fillimi i dritares FFT sinjali që vjen konsiderohet të jetë i dobishëm ose interferues. Zgjedhja e strategjisë më të përshtatshme të vendosjes dhe pozicionimit të dritares Fast Furrier Transform (FFT) për të demoduluar sinjalet e shumta të marra është e lidhur fort me cilësinë e shërbimit të sistemit. Janë pesë strategji për sinkronizimin e Dritares FFT: TL (sinjali i parë mbi nivelin e pragut), SS (sinjali më i fortë), CG (qendra e gravitetit), (QO) pothuajse optimale dhe C/I (C/I maksimal). Në marrës, dritarja FFT (Fast Fourier Transform) për të demoduluar sinjalin duhet të jetë e pozicionuar si duhet. Në këtë punim, dritarja FFT sinkronizohet me sinjalin e parë të marrë mbi nivelin e pragut, koha e mbërritjes së të cilit shënohet me  $t$ .

QoS në një pikë të marrësit varet nga raporti midis pjesës së dobishme të sinjalit (C) dhe pjesës interferuese të sinjalit (I).

Bazuar në karakteristikat e COFDM sinjalet me vonesë relative të përhapjes më të shkurtër se GI kontribuojnë në mënyrë konstruktive në pjesën e dobishme të sinjaleve të kombinuara, C, ndërkohë që sinjalet që arrijnë jashtë GI-së trajtohen si interferencë, I.


 FIGURA 13: FUNKSIONI I PESHIMIT  $w(\Delta t)$  PËR DVB-T2

- Kur jehona arrin brenda intervalit mbrojtës  $\Delta$ , fuqia e saj kontribon në sinjalet “e dobishme”;
- Kur jehona arrin jashtë intervalit mbrojtës  $\Delta$ , por brenda  $T_p$  (ekualizohet saktë), kontributi i saj ndahet në një komponent të dobishëm (pjesë e simbolit OFDM) dhe një komponent interferues (pjesë e simbolit të mëparshëm OFDM);
- Kur jehona arrin jashtë  $T_p$ , është interferencë e pastër me të njëjtin efekt si një zhurmë Gaussiane.

Raporti ndërmjet kontributit të dobishëm dhe interferues modelohet nga funksioni i ponderimit:

$$w_i = \begin{cases} 0 & \text{if } t \leq \Delta - T_p \\ \left(\frac{T_u+t}{T_u}\right)^2 & \text{if } \Delta - T_p < t \leq 0 \\ 1 & \text{if } 0 \leq t \leq \Delta \\ \left(\frac{(T_u+\Delta)-t}{T_u}\right)^2 & \text{if } \Delta < t \leq T_p \end{cases} \quad (3.1)$$

ku:

Ci: është kontributi i energjisë nga sinjali i-të në hyrjen e marrësit

C: është fuqia totale efektive e sinjalit të dobishëm

$I$ : është fuqia totale efektive interferuese

$w_i$ : është koeficienti i peshimit për përbërësin  $i$ -të

$T_u$ : është gjatësia e dobishme e simbolit

$\Delta$ : është gjatësia e intervalit roje

$t$ : është koha e mbërritjes së sinjalit

$T_p$ : është intervali gjatë të cilit sinjalet kontribuojnë dobishëm.

Për një vendodhje të caktuar të marrjes së sinjalit, fuqia e kontributit të dobishme ( $C$ ) dhe fuqia interferuese ( $I$ ) e sinjalit llogariten si më poshtë:

$$\begin{aligned} C &= \sum_i w_i C_i \\ I &= \sum_i (w_i - 1) C_i \end{aligned} \quad (3.2)$$

QoS në një vendodhje të caktuar të marrjes së sinjalit varet nga raporti Bartës/Interferencë dhe Zhurme (CINR), të shënuar me  $Y$ . Nëse nuk llogaritet interferenca nga rrjetet fqinjë të jashtëm dhe konsiderohet vetëm vetë-interferenca e SFN-së, barazimi merr formën si më poshtë

$$Y = \frac{U}{I+N} = \frac{\sum_{i=1}^N U_i}{\sum_{i=1}^N I_i + N} = \frac{\sum_{i=1}^N P_i w(i)}{\sum_{i=1}^N P_i [1-w(i)] + N} \quad (3.3)$$

Kur gjithashtu konsiderohet interferenca nga SFN-të e tjera fqinjë (co-channel), dhe duke supozuar që numri i përgjithshëm i transmetuesve në rrjetet ndërhyrëse është  $N_I$ ,  $Y$  mund të shkruhet si:

$$\frac{U}{I+N_0} = \frac{\sum_{i=1}^N U_i}{\sum_{i=1}^N I_i + \sum_{k=1}^{N_I} \tilde{I}_k + N_0} = \frac{\sum_{i=1}^N P_i w(i)}{\sum_{i=1}^N P_i [1-w(i)] + \sum_{k=1}^{N_I} \tilde{P}_k + N_0} \quad (3.4)$$

ku  $\tilde{P}_k$  është fuqia e marrë nga transmetuesi interferues i  $k$ -të.

Kriteri për cilësi të përshtatshme të shërbimit nënkupton që CINR të jetë më i lartë se Raporti i i caktuar i Mbrojtjes (PR) që imponohet nga parametrat e sistemit, shpejtësia e kodimit dhe lloji i kanalit. Meqë interferenca nga një sinjal OFDM është e ngjashme me zhurmën, PR mund të merret e barabartë me raportin e kërkuar bartëse zhurmë (C/N) të sistemit në shqyrtim.

Propabiliteti i mbulimit  $P_c$  për një piksel në pikën e marrjes së sinjalit është:

$$P_c > P\{y > PR\} = P\{y_{dB} > (PR)_{dB}\} \quad (3.5)$$

Një mënyrë tjetër, e aplikuar në këtë studim për zbutjen e interferencave ISI dhe përmirësimin e mbulimit është rregullimi i kohës së emetimit të secilit simbol nga secili transmetues. Nisja e sinjalit nga transmetuesi mund të vonohet për të rregulluar që të arrijë tek marrësi gjatë intervalit të mbrojtjes ose intervalit të ekualizimit. Rregullimi i vonesës statike ka një ndikim të drejtpërdrejtë në konfigurimin e vonesës relative në secilin pikë marrëse. Vonesat e nisjes së sinjalit në çdo transmetues të SFN-së optimizohen në mënyrë që zonat e vetë-interferuar të mund të zvogëlohen sa më shumë që të jetë e mundur. Zbatimi i vonesës statike në transmetuesit e SFN-së është provuar se përmirëson ndjeshëm mbulimin.

Nga sa më sipër, vetë-interferenca në rrjet mund të mbahet mjaft e ulët nga një zgjedhje e kujdeshme e parametrave të ndryshëm të sistemit. Optimizimi i parametrave të ndryshëm të rrjetit si dhe të vonesave statike të transmetuesve të SFN-së çojnë në reduktimin deri në eliminimin e interferencave ISI.

### 3.4 EFICENCA SPEKTRALE SHITESORE NË RRJETET SFN DVB-T2

Siç edhe u theksua më lartë, rritja e efijencës spektrale është duke u bërë gjithnjë e më shumë një faktor i rëndësishëm në mënyrë specifike për brezin UHF, pasi një sasi e konsiderueshme spektri i përdorur më parë për transmetimet televizive tani po ri-alokohet për përdorim nga gjeneratat më të fundit të sistemeve të komunikimit të lëvizshëm me brez të gjerë. Në të njëjtën kohë, kërkesat për cilësinë e transmetimeve televizive janë në rritje dhe HDTV është një domosdoshmëri për aparatet modern televizivë me ekrane të mëdha e të sheshtë. Transmetimi digjital kërkon gjerësi të madhe brezi dhe përmbajtje digjitale. DVB-T2 është projektuar për të përmbushur këto kërkesa, duke rritur efijencën spektrale në mënyrë fleksibël, nëpërmjet ofrimit të skenareve të ndryshme të marrjes së sinjalit duke zgjedhur opsionet më të mira të konfigurimit të parametrave teknikë.

Efijenca spektrale e një sistemi transmetimi radio përcaktohet si shpejtësia e transmetimit të të dhënave për njësi frekuence, e matur në bit/s/Hz. DVB-T2 ka një efijencë të lartë spektrale, veçanërisht për marrjen fikse.

Tabela 18 tregon efijencën spektrale në dy skenarë DVB-T2 të marrjes statike, të cilat janë marrë nga Raporti ITU-R BT.2254 “Frekuencat dhe aspektet e planifikimit të rrjetit të DVB-T2”. Këto dy skenarë janë simuluar në këtë punim.

FFT MODULIMI	TIPI I KODIMIT	GI [ $\mu$ s]	Data rate [Mbit/s]	C/N [dB]	TIPI I RRJETIT	MËNYRA E MARRJES SË SINJALIT	EFIÇENCA SPEKTRALE [bit/s/Hz]
32K ext 256 QAM	2/3	28	40.2	20.0	MFN	fixed	5.0
32K ext 256 QAM	2/3	448	33.4	21.2	Large SFN	fixed	4.2
32k ext 256 QAM	2/3	224	37.0	20.8	Medium SFN	fixed	4.6

**TABELA 18: PARAMETRAT E SISTEMIT DHE EFIÇENCA SPEKTRALE E DISA KONFIGURIMEVE TË RRJETIT DVB T2**

SFN-të rrisin gjithashtu efijencën e planifikimit të spektrit, pasi koncepti i alotmentit thjeshton aspektet teknike të procesit të koordinimit të frekuencave. Alotmentet SFN lejojnë, gjithashtu, përmirësimin e mbulimit në mënyrë progresive nëpërmjet shtimit të transmetuesve të rinj pa nevojën e një ri-planifikimit të përdorimit të frekuencës ose koordinimit shtesë të frekuencës për sa kohë që respektohen kufizimet e planit të shpërndarjes të frekuencës.

Në DVB-T2 për vlerësimin e efijencës spektrale përdoret koncepti i efijencës shtesore të spektrit. Shtesë konsiderohet bashkësia e kanaleve të frekuencës, së bashku me zonat e tyre të shërbimit, të cilat mund të përdoren për të siguruar mbulim të plotë kombëtar ose të pjesshëm të gjithë vendin.

Efiçenca shtesore e spektrit (LSE) është rezultat i përlllogaritjes së efijencës të spektrit të frekuencave të një sistemi transmetimi duke marrë në konsideratë një parametër të vlerësuar në mënyrë të veçantë në këtë punim që është distanca e ripërdorimit të frekuencës (një faktor që karakterizon distancën përtej së cilës një kanal mund të ripërdoret pa shkaktuar interferenca të dëmshme. Ripërdorimi i frekuencave ka një ndikim të madh në përgjithësi në konsumin e spektrit të një sistemi transmetimi. Për këtë arsye, LSE është më holistik se masat tradicionale të rritjes së efijencës spektrale të cilat zakonisht bazohen në performancën e një sistemi transmetimi në izolim. Si rrjedhim LSE përcakton sasinë totale të spektrit që një sistem kërkon për të ofruar një sërë shërbimesh në një hapësirë të caktuar të shërbyer nga disa rrjete që ripërdorin frekuenca dhe lejon një krahasim të drejtpërdrejtë të një sistemi me një tjetër, duke marrë parasysh faktorët si topologjia e rrjetit dhe planet e frekuencave. Efiçenca spektrale shtesore llogaritet me formulën e mëposhtme:



$$\text{Eficenca Spektrale Shtresore (LSE)} = \frac{\text{Eficenca Spektrale (SE)}}{\text{Faktori i Bllokimit të Ripërdorimit (RBF)}}$$

Megjithatë RBF është pa njësi matëse, LSE ka të njëjtën njësi matëse me efikasitetin spektral (SE); bit/s/Hz. Konsumi i spektrit, së bashku me konsideratat e kostos janë aspektet kryesore që përcaktojnë efikasitetin e një topologjie të caktuar rrjeti (SFN ose MFN).

Rrjetet SFN ofrojnë efikasitet më të lartë shtresore të spektrit në krahasim me rrjetet tradicionale MFN, për arsye të numrit më të vogël të frekuencave të përdorura në një shtresë.

Tabela 19 tregon efikasitetin spektral shtresor të dy skenarëve të ndryshëm të marrjes statike që përkatësisht i përkasin skenarit të SFN-ve egzistuese që kanë përmasat e një SFN-je mesatare dhe SFN-së së propozuar në këtë studim me përmasa të një SFN-je të madhe.

<b>TIPET E RRJETEVE DVB-T2</b>	<b>MËNYRAT E MARRJES SË SINJALIT</b>	<b>EFIÇENCA SPEKTRALE (SE) [bit/s/Hz]</b>	<b>FAKTORI BLOKIMIT TË RIPËRDORIMIT TË FREKUENCËS [bit/s/Hz]</b>	<b>EFIÇENCA SPEKTRALE SHITESORE (LSE) [bit/s/Hz]</b>
MFN	Fiks	5.0	7	0.71
SFN e madhe	Fiks	4.2	4	1.05
SFN e mesme	Fiks	4.6	5	0.93

**TABELA 19: EFIÇENCA SPEKTRALE SHITESORE NË TRE SKENARË TË MARRJES STATIKE DVB-T2**

Për mbulime rajonale, e cila kërkon SFN me madhësi mesatare, RBF konsiderohet 5 siç llogaritet në [BS 2014-1]. Për zona shërbime që kërkojnë SFN të mëdha RBF konsiderohet 4 ndërsa për SFN shumë të mëdha RBF merr vlerën 2.

Në rastin e këtij studimi, duke qënë se kalojmë nga dy SFN me madhësi mesatare, të cilat mund të konsiderohen si një rrjet MFN me dy frekuenca që zëvendësohet nga një SFN e madhe, Tabela 19 tregon diferencat e përlogaritura të efikasitetit spektral shtresor sipas të cilave rezultojnë se teknikat e ndjekura në këtë punim rrit LSE-në.

### 3.5 RRRITJA E MADHËSISË SË RRJETIT SFN

Një nga sfidat kryesore të SFN është shmangia e vetë interferencës, gjë që realizohet duke sakrifikuar një përqindje të rrjedhës së sinjalit për intervalin e mbrojtjes.

Rritja e madhësisë së një SFN-je do të thotë rritje e distancave midis transmetuesve, dhe në rastin e këtij studimi SFN e propozuar është pothuajse dyfish i SFN-ve aktuale. Kjo do të thotë se për të shmangur vet-interferencën, në kushtet kur nuk do të shtohen transmetues të rinj, kërkohet rritja e intervalit të mbrojtjes. Rritja e intervalit të mbrojtjes zvogëlon kapacitetin e transmetimit, por ndërkohë ky studim synon të mbulojë me një rrjet SFN të njëjtën zonë të mbuluar aktualisht nga dy SFN por pa ndryshuar kapacitetin e transmetimit dhe gjithashtu pa lejuar degradimin e sinjalit.

Marrëveshja GE-06 ka ofruar modele teorike si në seksionin më poshtë për rritjen e zonës së mbulimit, të cilat janë marrë në konsideratë në këtë studim.

### 3.5.1 MODELI TEORIK PËR RITJEN E ZONËS SË MBULIMIT TË SFN-SË

Studimi bazohet në një model teorik gjashtëkëndor të rrjetit SFN siç tregohet në Figurën 14. Rrjeti ka shtatë transmetues (Tx), njëri prej të cilëve është pozicionuar në qendër dhe gjashtë të tjerët në kufijtë e një hapësire gjashtëkëndore. Të gjithë transmetuesit në këtë model kanë të njëjtin  $h_{eff}$  dhe karakteristika e.r.p.. Të gjithë transmetuesit janë sinkronizuar në kohë dhe frekuencë.

Rrjeti mund të jetë i hapur ose i mbyllur. Zona e shërbimit të rrjetit të mbyllur kufizohet në zonën brenda vijës që ndërlidh të gjithë transmetuesit periferikë. Zona brenda linjës me vija të kuqe është një zonë e hapur e shërbimit të rrjetit, që është, gjithashtu, gjashtëkëndore dhe diametri i shërbimit  $D$  tejkalon atë të rastit të mbyllur me 15%.

Ky konfigurim bazë i rrjetit përdoret për të përcaktuar rrezen maksimale të mbulimit për e.r.p.-në e kërkuar dhe shërben si pikë fillimi për analizat në vijim.




FIGURA 14: RRJETI TEORIK GJASHTËKËNDOR SFN

Për sistemet numerike të transmetimit, probabiliteti i mbulimit duhet të jetë mjaft i lartë për të kapërcyer degradimin e shpejtë të cilësisë së sinjalit nga perfeksioni deri në rënie të plotë. Një minimum i probabilitetit të kërkuar të mbulimit është përzgjedhur të jetë prej 95% për marrjen indoor, outdoor fiks.

### 3.5.2 DISTANCA NDËRMJET STACIONEVE (ISD)

Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në distancën e ndarjes së transmetuesve, për shembull fuqia e rrezatuar, lartësia e antenës, mënyra e marrjes, varianti i sistemit dhe rruga e përhapjes. Duhet të theksohet se këto mund të jenë të ndryshme për rrjete të ndryshme.

Distanca e ripërdorimit të frekuencave midis dy zonave të mbulimit të shërbyera nga i njëjti kanal (co-channel) është distanca minimale e nevojshme për të shmangur interferencat e dëmshme në secilën prej dy këtyre dy zonave. Distanca e ripërdorimit të frekuencave ka një ndikim të rëndësishëm në numrin e blloqeve të frekuencës ose kanaleve të nevojshme për të krijuar mbulimin e një zone më të madhe që përmban disa vende ose rajone, secili me programet e veta.


Kohëzgjatja e intervalit të mbrojtjes rregullon madhësinë e vetë interferencës dhe si rrjedhim vonesën maksimale të jehonës së pranueshme nga sistemi dhe, në përputhje me rrethanat, distancën maksimale të mundshme ndërmjet dy transmetuesve në një SFN. Hapësira ndërmjet dy transmetuesve në një SFN nuk duhet do të jetë dukshëm më e madh se distanca e lejuar nga intervali i mbrojtjes, përveç nëse zgjidhet një mënyrë shumë "robust" transmetimi. Kufiri i

sipërm për maksimumin e kërkuar  $C/N$  është më i ulët sa më shumë ISD tejkalon distancën e GI.

Modeli si më poshtë është marrë si referencë për të analizuar madhësinë e mundshme që një SFN-së mund të arrijë. Madhësia rritet duke shtuar transmetues të mëtejshëm, pra unaza të mëtejshme të transmetuesve.

Efekti mbi mbulimin është se raporti i përgjithshëm  $C/I$  ndryshon. Në shumicën e rasteve raporti  $C/I$  zvogëlohet pasi shumë transmetues përtej distancës së GI shtohen, gjë që lejon rritjen e SI në rrjet.

Supozohet se ISD është një parametër fiks i rrjetit dhe, si i tillë, për llogaritjen e madhësisë SFN, topologjia e rrjetit të transmetimit bazohet në unaza shtesë gjashtëkëndore, siç tregohet në Figurën 15.



**FIGURA 15: MODELI I LLOGARITJES SË MADHËSISË MAKSIMAL SFN**

Kushti për mbulimin është që pikat marrëse të sinjalit brenda zonës së shërbimit të kenë një probabilitet mbulimi mbi vlerën minimale të kërkuar për të arritur cilësinë e kënaqshme të marrjes. Madhësia maksimale e SFN-së llogaritet duke shtuar unaza të njëpasnjëshme dhe duke derisa probabiliteti i mbulimit të mos bjerë prapë për të gjithë zonën e shërbimit. Një rrjet i mbyllur është përdorur për këtë lloj llogaritje mbulimi.

## 3.6 INTERFERENCAT E JASHTME

### 3.6.1 METODA E LLOGARITJES SË INTERFERENCËS SË JASHTME

Për llogaritjen e interferencës së jashtme të rrjetit referencë çdo pikë testimi e kufirit të allotmentit është marrë si një burim i interferencave të jashtme. Për këtë llogaritje është e

domosdoshme të dihet si është pozicionuar dhe orientuar rrjeti referencë në lidhje me pikën testimi në kufirin e allotmentit.

Të gjitha rrjetet referencë mund të karakterizohen si gjashtëkëndësha. Një brinjë (“brinja e startit”) e gjashtëkëndëshit është vendosur pingule me vijën midis pikës së testimit dhe pikës së llogaritjes. Qendra e brinjës së startit pozicionohet pastaj tek pika e testimit në kufi.

Në këtë pozicion vertikale të tjera dhe qendra e gjashtëkëndëshit janë më tepër larg nga pika e llogaritjes se vertikalja e brinjës start. Kjo fikson pozicionin e rrjetit referencë dhe transmetuesve të tij.

Rrjeti referencë lëviz pastaj rreth kufirit të allotmentit në një pikë tjetër testi, ku intensiteti i fushës është përsëri i vendosur për të njëjtën pikë llogaritje. Kjo procedurë përsëritet derisa rrjeti referencë kthehet në pozicionin e startimit.

Intensiteti i fushës në pikën e llogaritjes vlerësohet veçmas për çdo transmetues të rrjetit referencë. Për këtë qëllim, e. r. p. për rrjetet referencë DVB-T duhet të përfshijnë një rezervë fuqie prej 3 dB.

Rezultati i shumës së intensitetit të fushës të sinjaleve interferues përcaktohet nëpërmjet metodës së shumatores së fuqive. Përhapja me trase të përzier tokë-det llogaritet në bazë të Kapitullit 2 të Aneksit 2 të Marrëveshjes.

Një pamje e situatës është dhënë për të dy konfigurimet e mundshme të rrjetit referencë (3 transmetues dhe 7 transmetues) në Figurat 16 dhe 17.

Në sajë të lëvizjes të një gjashtëkëndëshi imagjinar rreth një kufiri kombëtar, mundet që një ose më shumë transmetues të rrjetit referencë të shtrihen jashtë territorit të administrimit për allotmentet e të cilëve kryhet llogaritja.




FIGURA 16: RN GJASHTËKËNDËSH ME TRE TRANSMETUES (RRC06-A4-SI-AP3-1)




FIGURA 17: RN GJASHTËKËNDËSH ME SHTATE TRANSMETUES (RRC06-A4-SI-AP3-1)

### 3.6.2 DISTANCA E RIPËRDORIMIT (RUD)

Distanca e ripërdorimit (RUD) është distanca minimale që duhet të respektojnë zonat e mbuluara nga e njëjta frekuencë për të shmangur interferencat.

Interferenca co-channel është në çdo rast më e lartë se efekti i vetë-interferencës. Në mënyrë që të kompensohet interferenca co-kanaleve, distanca ndërmjet rrjetit nën studim dhe atyre interferuese duhet të rritet me qëllim që të zvogëlohet fuqia e interferencave.

Me rritjen e kërkesave C/N, transmetimi bëhet më i ndjeshëm ndaj vetë-interferencave dhe interferencat në kanalet fqinjë. RUD rritet me rritjen e vlerës së pragut C/N. Kjo rritje është afërsisht lineare për aq kohë sa e.r.p. është mjaft e lartë për të siguruar kudo në zonën e shërbimit një buxhet lidhje që është shumë më lartë se niveli i zhurmës. Nëse buxheti i lidhjes i afrohet limitit të zhurmës, sjellja bëhet jolineare.




FIGURA 18: RUD NË FUNKSION TË ISD PËR MARRJEN FIKSE (PLANI GE-06)

### 3.6.3 MODELI PËR RILLOGARITJEN E DISTANCËS SË RIPËRDORIMIT

Në mënyrë që të llogaritet distanca minimale e ripërdorimit, modeli përcakton gjashtë SFN që interferojnë të vendosura simetrisht rreth SFN-së të kërkuar, siç tregohet në Figurën 19. Të gjitha rrjetet e padëshiruara janë identike me rrjetin e kërkuar, i cili konsiderohet i hapur.




FIGURA 19: MODELI I LLOGARITJES SË DISTANCËS SË RIPËRDORIMIT TË FREKUENCËS (EBU TECH3384)

Përveç vetë-interferencës së SFN-së së kërkuar, gjashtë rrjetet SFN të padëshiruara, që përdorin të njëjtën frekuencë, gjenerojnë nivele të interferencave të padëshiruara brenda rrjetit të kërkuar SFN qendër. Qëllimi është gjetja e distancës minimale të kërkuar ndërmjet SFN-së qendër dhe gjashtë SFN-ve periferike duke ruajtur interferencën e ndërsjelltë nën raportin e duhur të mbrojtjes. Për ta bërë këtë, gjashtë SFN-të interferuese lëvizin drejt SFN-së së kërkuar derisa probabiliteti i mbulimit në çdo vend brenda zonës së kërkuar SFN bie nën pragun minimal. Rrjeti konsiderohet i hapur. Kjo konsiderohet të jetë përfaqësuese e rastit më të keq dhe më realist për planifikimin e vërtetë se sa një rrjet i mbyllur kur interferenca e ndërsjelltë në mes të rrjeteve është analizuar.

Nëse unazat e mëtejshme shtohen në rrjet distanca e ripërdorimit do të rritet. Kjo do të thotë që raporti midis distancës së ripërdorimit dhe diametrit të zonës së shërbimit zvogëlohet. Në krahasimin e paraqitur në Tabelën 20 përdoren vlerat minimale e.r.p. të derivuara për 7-Tx SFN, të rritura me 3 dB për të përballuar interferencën shtesë të kanalit.

Kjo nënkupton që raporti ndërmjet distancës së ripërdorimit dhe diametrit të hapësirës së shërbimit është një tregues për efikasitetin e përdorimit të spektrit: një raport më i vogël, domethënë një diametër më i madh SFN në krahasim me RUD, tregon një ripërdorim më të mirë të frekuencës. Kështu, distanca e ripërdorimit do të ketë një ndikim në numrin e kanaleve të nevojshme për mbulimin e një rajoni ose vendi.



<b>C/N: (Mënyra 4: 17.4 dB/Mënyra 6: 21.3 dB/Mënyra 8: 24.8dB)</b>		
<b>ISD[km]/<math>h_{\text{eff}}</math> [m]</b>	<b>Numri i unazave</b>	<b>RUD [km]</b>
<b>60/150</b>	<b>1/1/1</b>	<b>176/213/247</b>
<b>60/300</b>	<b>2/1/1</b>	<b>140/163/192</b>
<b>30/80</b>	<b>2/2/2</b>	<b>131/165/197</b>
<b>30/80</b>	<b>3/3/3</b>	<b>139/175/208</b>
<b>15/40</b>	<b>4/4/4</b>	<b>99/133/167</b>
<b>15/40</b>	<b>11/7/6</b>	<b>108/147/175</b>

TABELA 20: DISTANCA E RIPËRDORIMIT PËR MARRJEN FIKSE (EBU TECH3384)

## KAPITULLI IV

# PËRZGJEDHJA E KONFIGURIMEVE OPTIMALE PËR RRJETIN SFN TË PROPOZUAR

### 4.1 PARATHËNIE

Në këtë kapitull synohet që të evidentohen konfigurimet e rrjetit SFN DVB-T2 që përmbushin qëllimin e këtij punimi, duke patur gjithmonë në konsideratë kufizimet që detyron Marrëveshja GE-06.

Pasi janë kryer analiza të çdo parametri teknik të rrjetit DVB-T2 (Kapitulli III), synohet të konkludohet me propozime konkrete të konfigurimeve të rrjetit SFN me madhësi sa hapësira që mbulojnë dy alotmentet egzistuese Tiranë dhe Fier duke ruajtur performancën e transmetimit.

### 4.2 ZGJEDHJA E PARAMETRAVE TË RRJETIT

Kur planifikohet një rrjet numerik SFN sigurisht iu referohemi kërkesave të rrjetit. Si gjithmonë duhet të bëhet një kompromis midis kapacitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit.

Mbulimi dhe performanca e një SFN-je është një rezultat i përbashkët i parametrave të të gjithë transmetuesve në SFN. Për shkak të numrit të madh të parametrave të përfshirë në proces, gjetja e konfigurimit të duhur është mjaft kompleks. Qëllimi i punimit është gjetja e konfigurimeve optimale për rrjetin SFN Tiranë-Fier. Duke ofruar më shumë mundësi të parametrave të sistemit sesa paraardhësi i tij DVB-T, DVB-T2 lejon rrjete më të mëdha SFN për të njëjtat parametra të sistemit. Sidoqoftë, vetë-interferenca në SFN krijon kufizime në distancën ndër-transmetuese dhe madhësinë e rrjetit. Në mënyrë që të bëhet përdorimi optimal i spektrit, e njëjta frekuencë ripërdoret në zona të ndryshme gjeografike - përtej distancës së ripërdorimit për të shmangur interferencat në kanal. Në këtë punim, është përdorur një metodologji e bazuar në modelet teorike të rrjetit për të garantuar ruajtjen e distancës së ripërdorimit të frekuencave. Një numër arkitekturash të rrjetit dhe modeleve të referencës së rrjetit janë marrë në konsideratë për marrjen fikse në mënyrë që të studiojmë efektet e parametrave të planifikimit në madhësinë SFN dhe distancën minimale të ripërdorimit të frekuencave. Shpejtësia e bitit, madhësia e rrjetit dhe distancat e ripërdorimit të frekuencave janë tre parametra të lidhur ngushtë ndërmjet tyre.

Për rastin e këtij studimi madhësia SFN pothuajse dyfishohet sikundër edhe distancat ndërmjet transmetuesve. Në zgjedhjen e gjatësisë së intervalit mbrojtës merret në konsideratë që nuk ndryshohen pozicionet e antenave dhe fuqitë e tyre të transmetimit, me qëllim mos shkaktimin

e interferencave të jashtme, shmangia e të cilave do të kërkonte koordinime intesive dhe kohë relativisht të gjatë.

DVB-T2 përdor teknikën më të fundit të modulimit dhe kodimit për të mundësuar rritjen e efikasitetit të përdorimit të spektrit të disponueshëm për transmetimet tokësore. Këto teknika të reja rrisin me 50% efikasitetin e DVB-T2 kundrejt çdo sistemi tjetër DTT në botë.

Si dhe në standardet e gjeneratës së parë DVB-T, DVB-T2 përdor modulimin OFDM (Multipleksimi Ortogonal me Ndarje në Frekuencë), me një numër të madh të *nën-bartësve* transportues të një sinjali.

Avantazhet e DVB-T2 kundrejt DVB-T përfshijnë ofrimin e parametrave teknik shtesë dhe të evoluuar. Dallimet kryesore të dy mënyrave të transmetimit DVB-T dhe DVB-T2 paraqiten në Tabelën 21. DVB-T2 përfshin inovacione të rëndësishme teknike, siç është gjenerata më e fundit e korigjimit të gabimit (FEC), konstelacioni i nivelit të lartë (256 QAM), rritje në numrin e bartësve OFDM (16K dhe 32K) me zgjerim opsional të gjerësisë së brezit, fraksione të reja të Guard Interval (GI), dhe optimizime të modelit Pilot Pattern (PP) sipas GI; por ajo gjithashtu përfshin funksionalitete të reja të tilla si PLP (Physical Layer Pipes), interleaver në kohë, "rotated constellations", mënyra e transmetimit Alamouti Multi-Input Single-Output (MISO), mekanizmat Peak to-Average Power Ratio (PAPR), (FEFs (Future Extension Frames), (GSE (Encapsulation Generic Stream)), dhe një profil "mobile" i njohur si T2-Lite.

Vlera më e lartë e madhësisë FFT 16k dhe 32k u futën për të rritur gjatësinë e intervalit të mbrojtjes pa ulur efikasitetin e spektrit.

	DVB-T	DVB-T2
FEC	Kodimi Konvolucional + RS 1/2, 2/3, 3/4, 5/6, 7/8	LDPC + BCH 1/2, 3/5, 2/3, 3/4, 4/5, 5/6
Modulimi	COFDM: QPSK, 16QAM, 64QAM	COFDM: QPSK, 16QAM, 64QAM, 256QAM
Intervali i sigurisë	1/4, 1/8, 1/16, 1/32	1/4, 19/256, 1/8, 19/128, 1/16, 1/32, 1/128
Madhësia FFT	2k, 8k	1k, 2k, 4k, 8k, 16k, 32k
Pilotët e shpërndarë	8% of total	1%, 2%, 4%, 8% of total
Brezat e frekuencave	Brezi III, IV/V (VHF, UHF)	Brezi III, IV/V (VHF, UHF) + L Brezi
Raster i kanalit	6, 7, 8 MHz	1.75, 5, 6, 7, 8, 10 MHz
Shkalla C/N (Rice channel)	5 (QPSK 1/2) to 23 dB (64QAM 7/8)	3(QPSK 1/2) to 24 dB (256QAM 5/6)
Distanca maksimale SFN Tx (8 MHz)	67.2 km (mënyra 8k)	159.6 km (mënyra 32k), 134.4 km (mënyra 16k)
Konstelacioni i rrotulluar	-	Amplifikimi i fuqisë në kanalet me multipath, SFN, interference...
Interleaving	Bit, frekuencë	Bit, qelizë, kohë, frekuencë
Larmishmëria	SISO (SIMO if diversity receiver)	SISO, MISO (SIMO, MIMO if diversity receiver)
Shpejtësia maksimale e bitit	31.7 Mbps (8k, 64QAM, CR = 7/8, GI = 1/32)	50.3 Mbps (32k, 256QAM, CR = 5/6, GI = 1/128, 1% scattered pilots)

TABELA 21: DVB-T2 KRAHASUAR ME DVB-T (DVB PROJECT)

Përzgjedhja e modelit më mirë të përshtatshëm të transmetimit është një aspekt i rëndësishëm i planifikimit në rrjetet DVB-T2. Konfigurimet e ndryshme (skema e modulimit, shpejtësia e kodimit dhe modeli pilot) ndikojnë në kufijtë e kërkuar C/N të marrësit që bashkë me kapacitetin e transmetimit përcaktojnë performancën e sistemit. Një kategorizim në kuptimin e shpejtësisë së bitit (bitrate) dhe diapazonit të vlerave C/N është dhënë në Tabelën 22.

VLERAT C/N DHE SHPEJTËSITË E TRANSMETIMIT TË BITIT PËR MARRJEN FIKSE		
Modeli i marrjes	Shpejtësia e transmetimit të bitit [Mbit/s]	Diapazoni C/N [dB]
Marrje fikse	18.3=<Shpejtësi<=36.9	13.3=<C/N<=23.2

TABELA 22: C/N DHE SHPEJTËSITË E TRANSMETIMIT TË BITIT (REPORT ITU-R BT.2254)

Për të llogaritur C/N e kërkuar për secilin model transmetimi për marrjen fikse aplikohet kanali Rician.

Në zgjedhjen e konfigurimit të rrjeti për DVB-T2 bëhet kompromis mes kapacitetit të transmetimit dhe qëndrueshmërisë së sistemit e cila ndërvaret nga kërkesat e rrjetit.

Siç edhe është theksuar, referenca kryesore për zgjedhjen e modelit të rrjetit SFN është përcaktimi i gjatësisë së intervalit të mbrojtjes apo distancave të transmetuesve brenda kësaj SFN-je bazuar në madhësisë fizike të hapësirës që kërkohet të mbulohet me shërbim.

Përzgjedhja e gjatësisë së intervalit të mbrojtjes ka një ndërvarësi reciproke nga madhësia FFT, e cila lidhet me skenarin e marrjes (në rastin tone për marrje fikse). Sigurisht tentohet drejt madhësive FFT të rendit të lartë si 16k apo 32k pasi një madhësi më e madhe FFT zvogëlon fraksionin e GI dhe rrit kapacitetin e transmetimit.

Zgjedhja e modulimit gjithashtu lidhet shpejtësinë e bitit (kapaciteti) si dhe qëndrueshmërinë e sistemit (robustness); skemat e modulimit të rendit më të lartë ofrojnë më shumë kapacitet por ndikojnë në uljen e qëndrueshmërisë së sistemit. Sidoqoftë, duhet të theksohet se për shkak të kodimit më efikas të kanalit, konstelacionit të rrotulluar, etj., të ofruar nga DVB-T2, 256-QAM do të kërkojë vlera C/N sa ato të kërkuara më parë për 64-QAM në DVB-T, që është vlera në rendin e 17-20 dB (EBU tech3384 dhe Report ITU-R BT.2254).

Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit do të ketë gjithashtu një ndikim të madh në performancën e SFN pasi që një C/N më e ulët e kërkuar do të zvogëlojë ndjeshmërinë për vetë-interferencën SFN.

Modelet Pilot (PP) të disponueshme në DVB-T2 (PP1 deri në PP8) një parametër tjetër që marrë vëmendje. Zgjedhja e modeleve pilot lidhet me performancën e sistemit, që siç jepet nga kufiri Nyquist, lidhet me sinjalet e vonuara që arrijnë jashtë intervalit të mbrojtjes. Zmadhimi i kufirit të Nyquist do të thotë që ekualizimi i kanaleve është i pasaktë dhe se mbrojtja ndaj interferencave ndër-simbole (ISI) është e vogël.

#### 4.2.1 PËRZGJEDHJA E INTERVALIT MBROJTËS (GI)

Për të shmangur interferencën ndër simbol (ISI), fillimi i secilit simbol paraprihet nga një hapësirë interval mbrojtje (GI). Gjatë intervalit të mbrojtjes të njëjtat simbole që arrijnë në marrës në kohë të ndryshme merren pa asnjë interferencë inter simbol (ISI). Për sa kohë që jehonat bien brenda këtij intervali, ato nuk do të ndikojnë në aftësinë e marrësit për të dekoduar në mënyrë të sigurt të dhënat aktuale, pasi të dhënat vlerësohen vetëm jashtë intervalit të mbrojtjes.

Ky parametër bazë në një rrjet SFN përcakton madhësinë e rrjetit, distancën ndërmjet transmetuesve (ISD) dhe si rrjedhim faktorin e ripërdorimit të frekuencave, të cilat lidhen drejtëpërdrejtë me eficientësinë spektrale shtesore (LSI).



FIGURA 20: INTERVALI I MBROJTJES (EBU TECH3384)

Distanca midis transmetuesve mund të llogaritet duke përdorur formulën si vijon:

$$D = (GI * T_U) * c$$

Në Tabelën 23 jepen distancat maksimale dhe minimale midis transmetuesve bazuar në madhësitë GI.

Distanca midis transmetuesve (D)	Interval i Mbrojtjes (GI)	Madhësia FFT	
		8K	32K
<b>Distanca Maksimale</b>	1/4	76.200 Km	268.8 Km
<b>Distanca Minimale</b>	1/128	2.1 Km	8.4 Km

TABELA 23: DISTANCA MIDIS TRANSMETUESVE (EBU TECH3384)

Në raste si edhe në këtë studim ku pozicioni i transmetuesve është i para përcaktuar, gjatësia e intervalit të mbrojtjes përcaktohet nga distanca e transmetuesve.

Duke qënë se në këtë punim dy SFN-të egzistuese kanë një interval mbrojtje  $1/16$ , për SFN-në e propozuar, në të cilën distanca maksimale midis transmetuesve pothuajse dyfishohet, propozohen të simulohen intervalet e mbrojtjes  $19/256$  dhe  $1/8$ .

Meqenëse intervali i mbrojtjes zvogëlon sasinë e kohës së disponueshme për transmetimin e të dhënave në një simbol, vendosja e tij ka një efekt negativ në shpejtësinë e transmetimit të bitit. Zgjatja e intervalit mbrojtës ul shpejtësinë e bitit.




FIGURA 21: EFEKTI I GI NË SHPEJTËSINË E TRANSMETIMIT

Për të ruajtur shpejtësinë e transmetimit të bitit, kur kërkohet rritja e madhësisë së SFN-së, si në rastin e këtij studimi, intervali i mbrojtjes zgjidhet më vogli i mundur që shmang interferencën ISI. Për të bërë të mundur këtë faktorë të tjerë që ndikojnë në minimizimin e vetë-interferencave merren në konsideratë si: madhësia FFT, modeli pilot, vendosja e përsëritësve (gap-filler), pozicionimi i intervalit të ekualizimit në marrës, vonesat statike në transmetuesit e SFN-së, të trajtuara dhe të marra në konsideratë në këtë punim.

#### 4.2.2 PËRZGJEDHJA E MADHËSISË SË FFT (FAST FOURIER TRANSFORM)

Në sistemet DVB-T ekzistojnë katër madhësi të ndryshme FFT: 1K, 2K, 4K, 8K, 16K dhe 32K. DVB-T2 shtoi dy madhësi më të gjata FFT, 16k dhe 32k. Rritja e numrit të bartësve rrit kohëzgjatjen e simbolit (1ms për 8k, 4ms për 32k), e cila ndihmon në rritjen e madhësisë së SFN pa rritur intervalin e mbrojtjes sepse gjatësia më e madhe e FFT do të japë një tolerancë më të madhe të vonesës për të njëjtin fraksion të intervalit të mbrojtës.

<i>Madhësia FFT</i>	<i>Kohëzgjatja – Tu (μs)</i>	<i>Numri i bartësve</i>
1k	112	853
2k	224	1705
4k	448	3409
8k	896	6817
16k	1792	13633
32k	3584	27265

TABELA 24: MADHËSITË FFT (REPORT ITU-R BT.2254-4)

Ose, për të njëjtin mbulim SFN, një madhësi më e madhe FFT zvogëlon kohëzgjatjen e intervaleve të mbrojtjes.

<i>INTERVALI I MBROJTJES</i>	<i>DVB-T 8K</i>	<i>DVB-T2 32K</i>
224 us	25%	6.25%
112 us	12.5%	3.12%

TABELA 25: MADHËSIA FFT DHE INTERVALI I MBROJTJES (REPORT ITU-R BT.2254)




FIGURA 22: FFT NË DVB-T2 (REPORT ITU-R BT.2254)

Duhet të theksohet se 32K përdoret kryesisht në transmetimet fikse për shkak të ndjeshmërisë së tij ndaj Doppler.




FIGURA 23: NDIKIMI I MADHËSISË FFT NË DVB-T2

Bazuar në sa më sipër, dhe gjithashtu në modelet teorike të rekomanduara nga ITU, për rastin e SFN-së Tiranë-Fier rekomandohet madhësia FFT 32k, si edhe përdoret në SFN-të ekzistuese.

#### 4.2.4 PËRZGJEDHJA E KONSTELACIONIT DHE EFEKTET E ROTACIONIT

Në DVB-T2, është shtuar skema e modulimit të lartë 256-QAM që mundësohet nga teknikat e reja të mbrojtjes së gabimeve.

Në specifikimin DVB-T2 është përfshirë teknika e konstelacionit të rrotulluar për të arritur një performancë më të mirë në skenarët e përhapjes. Qëllimi është rritja e rendit të diversitetit për të arritur një tepicë në bite informacioni të modulimit të koduar, për të përmirësuar performancën e marrësit në skenarë të vështirë të përhapjes.

Në konstelacionin normal marrësi në një pikë caktuar për të identifikuar se çfarë informacioni është transmetuar ka nevojë për të dy komponentët në-fazë (I) dhe kuadraturë (Q). Nëse ndonjë nga komponentët ndikohet nga humbje të konsiderueshme në kanal, simboli apo informacioni i transmetuar humbet.

Në rastin e një konstelacioni të rrotulluar, një kënd i caktuar rrotullimi zbatohet në planin kompleks në një konstelacion klasik të sinjalit, i tillë që secili komponent, I ose Q, të ketë informacion të mjaftueshëm për të gjetur se cili ishte simboli është transmetuar. Pamja e një konstelacioni të rrotulluar tregohet në Figurën 24, ku gjithashtu është vizatuar edhe konstelacioni përkatës konvencional. Pas rrotullimit, një proces ndërfitës kryhet vetëm mbi përbërësit Q në mënyrë që të transmetojmë veçmas I dhe Q të një pike konstelacioni në bartës të ndryshëm dhe madje edhe në hapësira të ndryshme kohore. Kështu, nëse një nga përbërësit shkatërrohet ose preket nga një shuarje e thellë selektive e kanalit, përbërësi tjetër mund të përdoret për të rikuperuar informacionin. Për më tepër, për shkak të këtij procesi ndërthurjeje, përbërësit në fazë dhe kuadraturë të një simboli të transmetuar ndikohen nga shuarjet e



pavarura. Rezultati i kësaj teknike është të rrisë fuqinë e marrësit në skenarët e përhapjes me shuarje të thella dhe/ose humbjes së plotë të sinjalit.




FIGURA 24: KONSTELACIONET E RROTULLUARA DHE KLASIKE (DVB-PROJECT)

Tabela 26 tregon numrin e biteve për çdo konstelacion në DVB-T2.

Konstelacioni DVB-T2	Numri i Biteve (n)	Këndi i rrotullimit (grade)
QPSK	2	29.0
16-QAM	4	16.8
64-QAM	6	8.6
256-QAM	8	$\text{atan}(1/16)$

TABELA 26: NUMRI I BITEVE PËR KONSTELACION (DVB-PROJECT)

Në DVB-T2, për shkak të kodimit më efikas të kanalit, modulimi 256-QAM me konstelacion të rrotulluar kërkon të njëjtat vlera C/N si ato të kërkuara me DVB-T për 64-QAM, në varësi të normës së kodit të përdorur.

Për SFN-në e propozuar në këtë punim është rekomanduar modulimi 256 QAM me konstelacion të rrotulluar.

#### 4.2.5 PËRZGJEDHJA E MODELIT PILOT

Në sistemin e koduar OFDM, një numër i madh bartësish fqinjë ortogonalë përdoren për të bartur të dhëna në disa kanale paralele. Një numër i vogël i bartësve janë caktuar për modelet pilot, të cilat përdoren për të vlerësuar kanalën. DVB-T2 mbështet tetë modele pilot të ndryshëm. Përzgjedhja e modeleve pilot varet nga konfigurimi i sistemit të përzgjedhur dhe mënyra e transmetimit: SISO (dalje të vetme hyrje të vetme) ose MISO (dalje të vetme hyrje të shumëfishtë).

Pilotët janë bartës që nuk përmbajnë informacion neto, por shërbejnë për qëllime të tilla siç janë vlerësimi i kanalit, ekualizimi, korigjimi i gabimit dhe sinkronizimi. Nga llojet e ndryshme të pilotëve si pilotë të vazhduar, të shpërndarë, P2 dhe pilotë të mbylljes së frame-it, vetëm pilotët e shpërndarë mund të ndryshohen.

Pilotët e shpërndarë përdoren nga marrësi DVB-T2 për të bërë matjet e kanalit dhe për të vlerësuar përgjigjen e kanalit për çdo qelizë OFDM në mënyrë që shtrembërimet në sinjalin e marrë të korigjohen. Sa më e lartë dendësia e pilotëve aq më mirë monitorohen luhatjet e kanalit në frekuencë dhe në kohë.

Në DVB-T2, janë të disponueshme tetë modele pilot, PP1 deri PP8. Meqenëse modele të caktuara janë më të përshtatshme për lloje të veçanta të kanaleve, diapazoni në modelet e pilotëve i jep planifikuesit të rrjetit më shumë liri për të përputhur mënyrën e transmetimit dhe modelin pilot me kanalën e synuar të transmetimit ose me ngarkesën e kërkuar. Për përcaktimin e modelit pilot që do përdoret duhet të merren parasysh faktorët në vijim:

Performanca Doppler: Modelet me një cikël përsëritje të shpeshtë (psh  $Dy = 2$ ), në të cilin pilotët përsërisin çdo sekondë simbolin OFDM, sigurojnë performancën më të mirë Doppler. Për rrjetet ku Doppler është një faktor dominues, si në rastin e marrësve të lëvizshëm, modelet 2, 4 ose 6 duhen konsideruar.

Kapaciteti: Modelet më pak të dendura, domethënë ato me distancën më të madhe midis pilotëve, si në kohë ( $Dy$ ) dhe në frekuencën ( $Dx$ ), sigurojnë transmetimin e një sasive më të

madhe të dhënash pasi më pak bartëse përdoren për pilotët, dhe rrjedhimisht të tjerat janë në dispozicion për të mbartur të dhëna.

Nga PP2 në PP8 numri i pilotëve të shpërndarë zvogëlohet ku teorikisht operacioni më i mirë pritet në PP2 dhe më e keqja është PP8. Secili prej modeleve është më i përshtatshëm për lloje të veçanta të kanaleve sesa të tjerat dhe kjo i jep planifikuesit të rrjetit më shumë liri për të përputhur mënyrën e transmetimit dhe modelin pilot me kanalin e synuar të transmetimit ose me ngarkesën.

Ka një ndërvarësi midis skenarit të marrjes së sinjalit dhe modelit pilot të përshtatshme.

Marrja fikse: Marrja fikse, e cila shqyrtohet në këtë punim me një sistem antenë të drejtuar zakonisht shfaq një ambient Doppler të ulët. Si e tillë PP7, që është më pak “robust” për Doppler mund të konsiderohet për të maksimizuar kapacitetin.

Në rrjetet SFN të mëdha ku zgjidhen intervale mbrojtje të gjatë p.sh. GI 1/8, si dhe në rastin e këtij studimi, modelet PP2 - PP4 rekomandohen. Me qëllim gjetjes së një ekuilibri ndërmjet performancës së Doppler dhe madhësisë së intervalit të mbrojtjes është provuar se modeli pilot 2 mund të sigurojë kompromisin më të mirë.

C/N ndërvaret në masë të konsiderueshme nga modeli pilot. Modelet më të dendura pilot ofrojnë një C/N më të lartë se ato me densitet më të ulët.

Distanca e vogël ( $D_x$ ) e pilotëve në PP1 e provon këtë model si më të fuqishëm ndaj interferencës intersimbol, ndërsa PP6 dhe PP7 janë më të prekshme ndaj tij.

Vetëm një set i modeleve piloti është i lejuar për çdo kombinim të madhësisë FFT dhe intervalit të mbrojtjes - këto janë paraqitur në Tabelën 27. Kjo tabelë vlen vetëm për modelin SISO (dalje të vetme hyrëse të vetme) të DVB-T2.

Madhësia FFT	Intervali i Mbrojtjes						
	1/128	1/32	1/16	19/256	1/8	19/128	1/4
32k	PP7	PP4 PP6	PP2 PP8 PP4	PP2 PP8 PP4	PP2 PP8	PP2 PP8	n/a
16k	PP7	PP7 PP4 PP6	PP2 PP8 PP4 PP5	PP2 PP8 PP4 PP5	PP2 PP3 PP8	PP2 PP3 PP8	PP1 PP8
8k	PP7	PP7 PP4	PP8 PP4 PP5	PP8 PP4 PP5	PP2 PP3 PP8	PP2 PP3 PP8	PP1 PP8
4k.2k	n/a	PP7 PP4	PP4 PP5	n/a	PP2 PP3	n/a	PP1
1k	n/a	n/a	PP4 PP5	n/a	PP2 PP3	n/a	PP1

TABELA 27: MODELI PILOT I SHPËRNDARË PËR KOMBINIME FFT-GI NE SISTEMIN SISO (DVB-PROJECT)

Për rastin e këtij punimi, në paragrafët e mësipërm 4.3.1 dhe 4.3.2 janë përzgjedhur si më të përshtatshmit për SFN-në e propozuar përkatësisht intervalet e mbrojtës GI 19/256 dhe GI 1/8 dhe madhësia FFT 32k. Bazuar në tabelën më sipër, modelet pilot që do të simulohen do të jenë përkatësisht: për kombinimin GI 19/256 – FFT 32K modelet pilot PP2 dhe PP4, ndërsa për kombinimin GI 1/8 – FFT 32K modeli pilot PP2.

Modeli pilot PP8 kërkon që marrësi të përdorë një strategji të barazimit të kanaleve që është krejtësisht ndryshe nga të tjerët. Asnjë marrës nuk dihet se ka inkorporuar këtë regjim, kryesisht për shkak të kompleksitetit shtesë të kërkuar në marrës. Për këtë arsye, modeli pilot PP8 nuk është simuluar në këtë punim.

Në figurat e mëposhtme, diagramat tregojnë pozicionimin e pilotëve të shpërndarë për modelet PP2, PP4 dhe PP8 në një rrjet tradicional SISO.




FIGURA 25: STRUKTURE E MODELIT PILOT SISO: PP2, PP4 DHE PP8 (DVB-PROJECT)

#### 4.2.6 FEC (KORIGJIMI I GABIMIT)

Për tu mbrojtur nga nivelet e larta të zhurmave dhe interferencave, DVB-T2 përdor kodet LDPC (Kontroll i barazisë me densitet të ulët) dhe BCH (Bose-Chaudhuri-Hocquengham) të cilat janë me efikasitet se kodimi (Convolutional and Reed-Solomon) përdorur nga DVB-T. DVB-T2 prezantoi shpejtësitë shtesë të kodeve 3/5 dhe 4/5, dhe hoqi shpejtësinë e kodit 7/8.

Variacionet në shpejtësitë e kodit ndihmojnë gjetjen e balancës midis shpejtësisë së transmetimit të bit-it dhe qëndrueshmërisë së sistemit. Sa më e vogël shpejtësia e kodit aq më e lartë qëndrueshmëria e sistemit (mbrojtja nga interferencat dhe zhurmat) por me koston e uljes së kapacitetit të transmetimit. Si e tillë shpejtësia më e vogël e kodit 1/2 zbatohet në rastet e niveleve të larta të ndërhyrjeve. Ndërkohë shpejtësia më e madhe e kodit 5/6 është varianti

më pak i përdorur për arsye të kapacitetit të ulët të transmetimit që ofron pavarësisht mbrojtjes së lartë kundrejt interferencave dhe zhurmave që ofron. Në rastin e SFN-ve me marrje të lëvizshme të sinjalit karakterizuar nga efekte të forta Doppler rekomandohet shpejtësi të vogla kodi.

Bazuar në rekomandimet teknike të dokumentit të Bashkimit të Transmetuesve Evropian – EBU tech3384 dhe Report ITU-R BT.2254 kandidati kryesor për marrje fikse në SFN me përmasa të mëdha është normat e kodit 2/3. Në rastin e këtij punimi, për të ruajtur apo përmirësuar performancën e rrjeteve egzistuese janë simuluar konfigurimet me shpejtësi kodi 2/3 dhe 3/4 (përdorur në rrjetet egzistuese SFN).

#### 4.2.7 TEKNIKAT MIMO DHE MISO

Rrjetet SFN janë konsideruar si më të favorshme për transmetimet numerike televizive, pasi reduktojnë në një masë të konsiderueshme fuqinë e transmetimit për të njëjtën cilësi sinjali krahasuar me rrjetet MFN. Megjithatë, edhe në rrjetet SFN ka raste të degradimit të performancës së sinjalit për shkak të interferencave inter simbol ISI. Zgjidhja e prezantuar nga Projekti Digital Video Broadcasting (DVB) është aplikimi i teknikave MISO (Multi Input - Single Output) dhe MIMO (Multi Input - Multi Output) në transmetimet televizive. Parimi ku bazohen këto teknika është diversiteti hapësinor i transmetimit të sinjalit që sjellin dy avantazhe të mëdha krahasuar me teknikën SISO (Single Input - Single Output):

1. Nëpërmjet diversitetit hapësinor përmirësohet cilësia e lidhjes duke sinjalizuar në rastet kur ka shuarje në kanalet e transmetimit.
2. Nëpërmjet multipleksimit hapësinor mundësohet rritja e shpejtësisë së biteve të informacionit pa rritur gjerësinë e brezit ose fuqinë e transmetimit.

Në rrjetet DVBT-2 është zbatuar së pari teknika MISO, e cila përdor pjesërisht avantazhet e teknikës MIMO. MISO është një teknikë e transmetimit divers e bazuar në kodimin hapësinor-kohë që siguron rezistencë të lartë ndaj degradimit të sinjalit. Standardi DVB-T2 ofron teknologjinë MISO duke përdorur një matricë të modifikuar Alamouti. Në teknikat MISO rritet vetëm numri i antenave transmetuese ndërsa në pajisjen marrëse aplikohen disa modifikime. Ndërkohë në rastin e teknikës MIMO shtohen antena edhe tek marrësi. Si rrjedhim, për arsye të numrit të madh të pajisjeve marrëse, zbatimi i teknikës MIMO kërkon një investim të konsiderueshëm në infrastrukturë. Për këtë arsye, është duke u studiuar nëse përmirësimi që sjell teknika MIMO në performancën e sistemit e justifikon investimin e madh në infrastrukturë.

Konfigurimi i rrjetit MISO është paraqitur në Figurën 26. Referuar diagramës shihet se në rrjetit MISO transmetimi i sinjalit bëhet në të njëjtën kohë në versione të ndryshme. Në figurat më

poshtë, është paraqitur rasti më i thjeshtë ku në çdo pikë transmetimi vendosen vetëm dy transmetues dhe sinjali transmetohet në dy variante të ndryshme.

Zakonisht, megjithëse jo domosdoshmërisht, transmetuesit janë të ndarë gjeografikisht nga njëri-tjetri, pasi ky është përgjithësisht konfigurimi më i dobishëm. Në këtë mënyrë rrjeti përdor më mirë avantazhet e diversitetit të transmetimit në mënyrë që të përmirësojë SNR e sistemit.




FIGURA 26: RRJETI DVB-T2 MISO (DVB-PROJECT)

Ky sistem bazohet në konceptin e kodimit Alamouti. Nga një antenë transmetohet versioni i pandryshuar i sinjalit origjinal dhe nga antena tjetër transmetohet një version i modifikuar, ku simbolet këmbehen në çifte (në domenin e frekuencës) konjurohen dhe, përveç kësaj, njëri prej tyre invertohet. Duke kryer këtë proces, sinjalet në marrje kombinohen në mënyrë të tillë që SNR të rezultojë më e lartë. Komplexiteti ekstra i futur nga përdorimi i kësaj teknike është i papërfillshëm në anën e marrësit.

Megjithatë të dy antenat (ose grupet e antenave), secili që përfaqëson një kanal divers, transmetojnë sinjalin e tyre nga vendndodhje të ndryshme, dëmtimet e kanalit që ndikojnë në çdo sinjal divers ndryshojnë. Është statistikisht e pamundur që dëmtimi të prekë të dy kanalet në të njëjtën kohë në të njëjtën mënyrë. Duke njohur statusin e secilit kanal, marrësi mund të kombinojë të dy sinjalet në mënyrë të tillë që të favorizojë pjesët e sinjalit që janë më pak të degraduara. Si rrjedhim, sinjali i kombinuar paraqitet në marrës me  $C / I$  më të lartë kundrejt një kanali të vetëm, ndërkohë që transmetuesit transmetojnë me gjysmën e fuqisë së kërkuar në SISO.




FIGURA 27: MATRIXA ALAMOUTI MISO (DVB-PROJECT)

#### 4.3.7.2 RASTE TË PËRFITIMEVE NGA TEKNIKA MISO

Një rrjet MISO është më i dobishëm kur sinjalet me madhësi të barabartë nga dy grupe të ndryshme transmetuesish janë të kombinuara. Prandaj, duhet të merret në konsideratë maksimizimi i mbivendosjeve të sinjaleve ndërmjet dy grupeve për të përfituar “gain” më të madh.

Rrjetet portabël dhe të lëvizshme zakonisht kanë më shumë gjasa të përfitojnë nga teknika MISO, pasi ato në përgjithësi përmbajnë më shumë antena omnidireksionale në marrje, gjë që do të rriste mundësinë e mbivendosjes së sinjaleve. Për më tepër, në këto raste rrjeti i transmetuesve ka tendencë të jetë më i dendur si rrjedhim transmetuesit do kenë fuqi më të ulët, gjë që mund të rris mbivendosjen.

Rrjetet fikse me antena relativisht direksionale mund të mos jenë të përshtatshme për rrjetin MISO, përveç nëse antenat transmetuese janë vendosur relativisht afër së bashku dhe bien afërsisht brenda gjerësisë së rreze të shumicës së antenave në marrje.

Megjithatë ekzistojnë vetëm dy "variante" të mundshme të sinjalit të transmetuar kur aplikohet MISO, në praktikë mund të jetë e vështirë të rregullohen transmetuesit në dy grupe në mënyrë



që të maksimizohet fitimi MISO në SFN me zonë mbulimi të madh. Megjithatë, në një rrjet SFN me një transmetues kryesor qendror të rrethuar nga disa transmetues të vegjël, mundësohet përfitim më efikas nga MISO. Mbivendosja midis stacioneve të vegjël do të ishte i vogël dhe mbivendosja e mbulimit do të ekzistonte midis transmetuesit kryesor dhe stacioneve që e rrethojnë. Transmetuesit kryesor caktohet atëherë si njëri nga grupet e transmetuesve dhe stacionet e tjerë në grupin tjetër transmetues.

Megjithatë, ashtu si në rrjetet SISO, ka disa kufizime të rëndësishme në dizenjimin e sistemit MISO që kufizojnë zgjedhjen e mundshme të intervalit të mbrojtjes dhe modelit pilot. Për shembull, në regjimin MISO intervali i mbrojtjes 1/4 nuk është i disponueshëm.

Madhësia FFT	Intervali i Mbrojtjes						
	1/128	1/32	1/16	19/256	1/8	19/128	1/4
32k	PP8 PP4 PP6	PP8 PP4	PP2 PP8	PP2 PP8	n/a	n/a	n/a
16k	PP8 PP4 PP5	PP8 PP4 PP5	PP3 PP8	PP3 PP8	PP1 PP8	PP1 PP8	n/a
8k	PP8 PP4 PP5	PP8 PP4 PP5	PP3 PP8	PP3 PP8	PP1 PP8	PP1 PP8	n/a
4k, 2k	n/a	PP4 PP5	PP3	n/a	PP1	n/a	n/a
1k	n/a	n/a	PP3	n/a	PP1	n/a	n/a

TABELA 28: MODELI PILOT I SHPËRNDARË PËR KOMBINIME FFT-GI NË SISTEMIN MISO (EBU TECH3384)

Për qëllimet e këtij punimi, ku konfigurimet e konsideruara më të përshtatshme për rrjetin SFN të propozuar përmbajnë kombinimet FFT 32K – GI 19/256 dhe FFT 32K – GI 1/8, regjimi MISO mund të zbatohet vetëm për kombinimin e parë me modelet pilot PP2 dhe PP8. Ndërkohë modeli pilot PP8 nuk mund të përdoret derisa marrësit të kenë të inkorporuar një strategji të barazimit të kanalit që është thelbësisht e ndryshme nga të tjerët dhe asnjë marrës ende nuk e ka përfshirë. Si rrjedhim, të vetmet konfigurime rrjeti që mund të simuloheshin në rastin e këtij punimi për regjimin MISO janë ato që përmbajnë kombinimet FFT 32K – GI 19/256 – PP2.

Për arsye të kufizimeve, të përmëndura më sipër, që regjimi MISO paraqet në topologji rrjeti fiks si në rastin e rrjetit SFN të propozuar në këtë punim, studimi nuk përmban simulime të rrjetit bazuar në këtë teknikë. Përfitimet e teknikës MISO në përmirësimin e performancës së

rrjetit SFN Tiranë – Fier do jenë objekt i studimeve të mëtejshme që do të vijojnë në përpjekje të lirimit të plotë të brezit DD2.

#### 4.2.8 SKENAR I ZBATIMIT TË SFN TË MËDHA

DVB-T2 ofron një diapazon shumë më të gjerë të zgjedhjeve të parametrave sesa DVB-T. Mundësitë e zgjedhjes janë aq të mëdha saqë nuk është e mundur të marrin në konsideratë të gjitha kombinimet e mundshme.

Për qëllimin e këtij punimi është marrë në konsideratë skenari i rekomanduar në EBU Tech 3348 SFN për marrjes fikse me përmasa të mëdha. Parametrat bazohen në të dhënat e specifikuara nga ETSI në Udhëzimin Implementues [TS 102 831, EN 302 755].

Në skenarët e SFN-ve me hapësirë mbulimi të madh dhe madhësi mesatare sugjerohet që të përdoret madhësia FFT 32k, për shkak të ndjeshmërisë ndaj Doppler. Megjithatë FFT 16k mund të jenë gjithashtu e përshtatshme. Kjo do të rezultojë në përdorimin e një fraksioni më të lartë të GI, dhe kështu kapacitet të reduktuar, për të arritur kohëzgjatjen e kërkuar të intervalit të mbrojtjes.

Për SFN-të e mëdha në parim është gjithashtu e rekomanduar gjatësia e intervalit të mbrojtjes GI 1/8, megjithatë rezultatet kanë treguar se edhe gjatësia e intervalit të mbrojtjes G/I 19/256 është e mjaftueshëm për të shmangur vetë-interferencat në SFN.

Gjerësia e Brezit	8 MHz
Madhësia FFT:	32K
Bartësi:	I zgjeruar
Modeli Pilot i Shpërndarë:	PP2
Intervali i Mbrojtjes:	1/8 (448 $\mu$ s)
Modulimi:	256 QAM
Norma e kodit:	2/3
C/N (Rice)	21.2 dB
Shpejtësia e të dhënave	33.4 Mbit/s

TABELA 29: MARRJE FIKSE PËR SFN ME HAPËSIRË MBULIMI TË MADH (EBU TECH3384)

## KAPITULLI V

### OPTIMIZIMI I MBULIMIT TË RRJETIT SFN TIRANË-FIER

#### 5.1 ASPEKTET E LLOGARITJES SË MBULIMIT PËR DVB-T2 SFN

Në mënyrë që të llogaritet mbulimi dhe niveli i interferencave të SFN-së Tiranë-Fier, kufijtë e zonë së shërbimit dekompozohen në një numër të madh elementësh së vegjël (pixels), afërsisht në formë katrore, (p.sh.,  $2 \times 2$  km) të quajtur Pika Testimi (TPs (testpoints)). Një TP përshkruhet nga gjerësia, gjatësia, lartësia dhe numri i banorëve, dhe përfaqëson sjelljen e çdo marrësi (p.sh. një antenë marrëse e përdoruesit) brenda tij. Për shkak të natyrës gjenerike të rezultateve, llogaritjet janë kryer mbi një terren homogjen të sheshtë duke përdorur modelin e përhapjes ITU-R Rec.P.1546-4.

Brenda çdo zone të vogël, forca e fushës  $P$  paraqet variacion të rastësishëm me vendndodhjen për shkak të shuarjeve dhe supozohet të jetë një variacion i rastit normal (log-normal) (RV) me mesataren  $\mu$  dhe devijimi standard  $\sigma$ .  $\mu$  llogaritet sipas modelit të përhapjes të ITU-R Rec.P.1546-4.

Vlera e  $\sigma$  për shpërndarjen e forcës së fushës mund të llogaritet me barazimin:

$$\sigma = \sqrt{\sigma_0^2 + \sigma_1^2} \quad (5.1)$$

ku  $\sigma_0$  dhe  $\sigma_1$  janë respektivisht devijimet standarde nga shuarjet dhe humbjet e depërtimit në ndërtesa. Në UHF, vlera mesatare e humbjes së depërtimit në ndërtesa është 11 dB dhe devijimi i tij standard  $\sigma_1$  është 6 dB.

Duke pasur parasysh tranzicionin shumë të shpejtë nga marrja e kënaqshme në dështimin e plotë të marrjes dhe për shkak të kërkesave të cilësisë së lartë të shërbimit (QoS) në transmetimet numerike, planifikimi i televizionit digjital bazohet në mbrojtjen 99% të kohës nga interferencat. Kështu që vlerat e fuqisë së fushës që tejkalojnë për 1% të kohës përdoren për sinjalin e padëshiruar ( $E_{\text{interferenca}} 1\%$ ), i cili është afër mbrojtjes 99% të kohës dhe vlerat e fuqisë së fushës tejkalojnë për 50% të kohës për sinjalin e kërkuar ( $E_{\text{dobishme}} 50\%$ ).

#### 5.2.1 PIKAT E MATJEVE PËR PËRCAKTIMIN E MBULIMIT

##### Allotmenti i Tiranës

Kanali frekuencore për këtë allotment është Ch 53.

Pikat e testimit të këtij allotmenti janë në përputhje me përcaktimet e GE-06 (në total 10 pika testimi).

6	AL005D
---	--------

8	1
---	---

9a	1
9b	10

9c1	413426	413001	412321	412018	411717	410141	410748	412217
9c2	0192721	0193126	0192510	0192526	0193054	0192712	0195525	0201533
9c1	412555	413338						
9c2	0200228	0194813						




FIGURA 28: PIKAT E TESTIMIT TË ALLOTMENTIT TË TIRANËS (AMA)

### Allotmenti i Fierit

Kanali frekuencore për këtë allotment është Ch 28.

Pikat e testimit të këtij allotmenti janë në përputhje me përcaktimet e GE-06 (në total 10 pika testimi).

6	AL007D
---	--------

8	1
---	---

9a	1
9b	10

9c1	410141	405409	403907	402935	402414	402903	404507	405021
9c2	0192712	0192337	0192025	0194410	0194543	0195047	0194400	0194758
9c1	405738	410417						
9c2	0194128	0193748						




FIGURA 29: PIKAT E TESTIMIT TË ALLOTMENTIT TË FIERIT (AMA)

Kanali frekuencor për allotmentin e ri do të jetë Ch 28.

Pikat e testimit për përcaktimin e mbulimit mbeten të pandryshuara edhe pas optimizimit të rrjetit.




FIGURA 30: PIKAT E TESTIMIT TË ALLOTMENTI TIRANË-FIER PAS OPTIMIZIMIT (AMA)

## 5.2 PARAMETRAT E RRJETEVE EGZISTUES TË SFN TIRANË DHE SFN FIER

Territori i Shqipërisë është ndarë në njëmbëdhjetë allotmente të cilat mbulohen secila nga një rrjet SFN. Bashkësia e kanaleve të frekuencës (11 SFN-ve), së bashku me zonat e tyre të shërbimit mundësojnë rrjete (shtresa) me mbulim të plotë kombëtar dhe disa rrjete (shtresa) rajonale/lokale në gjithë vendin. Të gjitha këto rrjete përdorin teknologjinë DVB-T2 dhe teknikën e kompresimit MPEG4.




FIGURA 31: RRJETET NUMERIK I KOMBËTAR (AMA)

Rrjetet kombëtare apo lokale janë kombinim i SFN-ve të mëposhtme:

- Mux 1.1 - Rrjet SFN Shkodër. Headend në Shkodër.
- Mux 1.2 - Rrjet SFN Kukës. Headend në Kukës.
- Mux 1.3 - Rrjet SFN Dibër. Headend në Dibër.
- Mux 1.4 - Rrjet SFN Lezhë. Head End në Lezhë.
- Mux 1.5 - Rrjet SFN Tiranë. Headend në Tiranë.
- Mux 1.6 - Rrjet SFN Elbasan. Headend në Elbasan
- Mux 1.7 - Rrjet SFN Fier. Headend në Fier
- Mux 1.8 - Rrjet SFN Berat. Headend në Berat.
- Mux 1.9 - Rrjet SFN Korçë. Headend në Korçë
- Mux 1.10 - Rrjet SFN Gjirokastër. Headend në Gjirokastër

Mux 1.11 - Rrjet SFN Vlorë. Headend në Vlorë.

Në këtë studim janë marrë si referencë rrjetet SFN Tiranë dhe Fier të një prej operatorëve të rrjetit numerik kombëtar. Rrjeti numerik kombëtar ka detyrimin të realizojnë një mbulim të popullsisë në masën prej 95% për zonat urbane dhe 70% për zonat rurale.

Për rastin e marrë në studim janë marrë në konsideratë të dhënat e mëposhtme të rrjetit aktual:

- Modeli i ngritjes numerike: 50x50 m
- Modeli i llogaritjes së forcës së fushës: IRT2D, gjatësia e antenës së marrësit 10 m, pa morfo
- Kufijtë e zbatimit: Sipas udhëzuesit për implementimin e DVB-T2
- Probabiliteti lokal: 95% urban dhe 90% periferike, 70% rurale dhe 50% periferike
- Link buxheti bazuar në ETSI TR 102 831
- Vlerat e link buxhetit janë të ngjashme me vlerat e forcës së fushës të përcaktuara nga EBU (raport EBU TECH 3348, maj 2011).
- Modulatori mbështet modulimin DVB-T2 në përputhje me EN 302 755.
- Modulatori mbështet skemat e mëposhtme të modulimit;
  - QPSK
  - 16 QAM
  - 64 QAM
  - 256 QAM
- Modulatori mbështet kanalet e bandwidthit 1,7 MHz, 5 MHz, 6 MHz, 7 MHz ose 8 MHz
- Modulatori mbështet intervale mbrojtëse nga 1/128 në 1/4
- Modulatori mbështet transportuesit 2K, 4K, 16K dhe 32K dhe mënyrën e zgjatur.
- Modulatori mbështet shpejtësitë e kodit nga 1/2 deri në 5/6.

Si më poshtë janë hartat e mbulimit të allotmenteve (rrjeteve lokale numerike SFN) Tiranë dhe Fier.






FIGURA 32: HAPËSIRAT E MBULIMI TË SFN TIRANË (AMA)



FIGURA 33: HAPËSIRAT E MBULIMI TË SFN FIER (AMA)

Distancat midis transmetuesve në SFN-të aktuale Tiranë dhe Fier:

Allotmenti Tiranë

Fushë Dajt - Kodër Ishëm 33.1 Km

Fushë Dajt- Kavajë 36.7 Km

Kodër Ishëm- Kavajë 39.7 Km

Allotmenti Fier

Likovun-Ardenicë 17.7 Km

Likovun- Ballsh 19.7 Km

Ardenicë- Ballsh 28 Km

Callsign	Address	Info(2)	X Y Z code	Antenna (m)	Rad power (W)	Nominal power (W)	Frequency MHz	Azimuth (°)
QFR_AL007D	Ardenice	Ch 28	19.35379 40.49290 160 4DMS	50	2238	891	530	0
QFR_AL007D	Ballsh	Ch 28	19.43050 40.35201 463 4DMS	8	2238	891	530	0
QFR_AL007D	Likovun	Ch 28	19.30559 40.40361 240 4DMS	15	2238	891	530	0
QTR_AL005D	Kavaje	Ch 53	19.33486 41.10545 36 4DMS	35	724	457	730	0
QTR_AL005D	Koder Ishem	Ch 53	19.35513 41.32211 137 4DMS	15	724	457	730	200
QTR_AL005D	Fushe Dajt	Ch 53	19.55182 41.22013 1613 4DMS	15	724	457	730	0

TABELA 30: PARAMETRAT TEKNIKË TË STACIONEVE TRANSMETUES NE SFN-TË AKTUALE TIRANË DHE FIER (AMA)




FIGURA 34: STACIONET TRANSMETUESE TË MBULIMIT KOMBËTAR (AMA)

Më poshtë tregohet harta e mbulimit aktual në alotmentet e Tiranës dhe Fierit.




FIGURA 35: ALLOTMENTI I TIRANËS DHE FIERIT PARA OPTIMIZIMIT (AMA)




FIGURA 36: MBULIMI AKTUAL I SFN-VE TIRANË DHE FIER PËR EFEKT KRAHASIMI (AMA)

Allotmenti Tiranë - Fier

Fushë Dajt- Kodër Ishëm 33.1 Km

Fushë Dajt- Kavajë 36.7 Km

Kodër Ishëm- Kavajë	39.7 Km
Fushë Dajt- Ardenicë	66.4 Km
Fushë Dajt- Likovun	84.1 Km
Fushë Dajt- Ballsh	88 Km
Kodër Ishëm- Ardenicë	79.1 Km
Kodër Ishëm- Ballsh	105.6 Km
Kodër Ishëm- Likovun	95.8 Km
Kavajë- Ardenicë	39.6 Km
Kavajë- Likovun	56.1 Km
Kavajë- Ballsh	66.8 Km
Likovun-Ardenicë	17.7 Km
Likovun- Ballsh	19.7 Km
Ardenicë- Ballsh	28 Km

Callsign	Address	Info(2)	X Y Z code	Antenna (m)	Rad power (W)	Nominal power (W)	Frequency MHz	Azimuth (°)
QFR_AL007D	Ardenice	Ch 28	19 35379 40 49290 160 4DMS	50	2238	891	530	0
QFR_AL007D	Ballsh	Ch 28	19 43050 40 35201 463 4DMS	8	2238	891	530	0
QFR_AL007D	Likovun	Ch 28	19 30559 40 40361 240 4DMS	15	2238	891	530	0
QTR_AL005D	Kavaje	Ch 28	19 33486 41.10545 36 4DMS	35	724	457	730	0
QTR_AL005D	Koder Ishem	Ch 28	19 35513 41.32211 137 4DMS	15	724	457	730	200
QTR_AL005D	Fushe Dajt	Ch 28	19 55182 41.22013 1613 4DMS	15	724	457	730	0

TABELA 31: PARAMETRAT TEKNIKË TË STACIONEVE TRANSMETUES NE SFN-NË E PROPOZUAR TIRANË-FIER (AMA)

### 5.3 METODOLOGJIA E APLIKUAR PËR OPTIMIZIMIN E MBULIMIT

Nisur nga fakti që teknologjia DVB-T2 ofron SFN me rreze mbulimi më të madh se DVB-T, optimizimi ka si objekt bashkimin e dy SFN-ve Tiranë dhe Fier si një rast studimi që siguron lirim të një frekuence, e cila i përket brezit të Dividentit të dytë Numerik (DD2). Bashkimi i dy SFN-ve, të cilat së bashku përbëjnë një MFN, do të bëhet duke garantuar që nuk preket Plani GE-06, me qëllim që të shmanget nevoja për koordinim me administratat e prekura, të cilat sic përcaktohet në këtë plan përfshijnë vendet fqinjë brenda rrezes 1000 km. Kjo do të thotë të ruhen të pandryshuar pozicionet e stacioneve transmetuese, nuk shtohen stacione të reja transmetuese (përveç përsëritësve kur konsiderohet e domosdoshme) si dhe ruhen fuqitë e tyre të transmetimit.

Hapësirat ku shtrihen dy rrjetet aktuale SFN të Tiranës dhe Fierit shfaqin një orografi shumë komplekse. Çdo pikë marrëse konsiderohet që mbulohet me shërbim vetëm nëse të dy kushtet  $C > C_{min}$  dhe  $C / I > (C / I)_{min}$  janë të përmbushur.

Për allotmentin e Tiranës aktualisht përdoret kanali frekuencor Ch 53 dhe për allotmentin e Fierit kanali Ch 28. Duke qenë se kanali Ch 53 bën pjesë në kanalet e brezit DD2 dhe duhet të

lirohet, atëherë në allotmentin e zgjeruar që mbulon dy allotmentet egzistuese Tiranë dhe Fier do të përdoret kanali Ch28.

Në studimin e kryer për realizimin e mbulimit me sinjal numerik të allotmentit të ri, është mbajtur parasysh mbulimi i territorit duke ruajtur apo përmirësuar kapacitetin e transmetimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit. Gjithashtu, zgjerimi i rrjetit SFN Tiranë deri në masën që të mbulojë dhe allotmentin e Fierit bazohet në ruajtjen e pozicioneve të antenave transmetuese dhe të fuqive të tyre të transmetimit me qëllim shmangien e interferencave të jashtme. Me qëllim mbrojtjen nga interferencat e jashtme janë nënshkruar disa marrëveshje ndërkufitare koordinimi me vendet fqinjë, të cila janë marrë në konsideratë gjatë këtij studimi.

Optimizimi i mbulimit është kryer bazuar në simulimet me programin profesional të planifikimit të frekuencave audio/audiovizive “HTZ Communications”.

Mbulimi me shërbim televiziv digjital karakterizohet nga një kalim shumë i shpejtë nga marrja gati perfekte e sinjalit në humbjen e plotë të tij dhe si e tillë bëhet shumë e vështirë mundësia e përcaktimit të saktë të zonave të mbuluara me sinjal dhe atyre ku mbulimi mungon pothuajse tërësisht. Mbulim "i mirë" konsiderohet rasti kur 95% e vendndodhjeve brenda një zone të vogël janë të mbuluara dhe "e pranueshme" kur 70% e vendndodhjeve brenda një zone të vogël janë të mbuluara.

Bazuar në analizat e parametrave teknik të rrjetit SFN në teknologjinë DVB-T2, si në Kapitullin IV, janë klasifikuar si më të përshtatshme konfigurimet e renditura më poshtë për rrjetin SFN që mbulon dy allotmentet egzistuese Tiranë dhe Fier:

- BW 8MHz, 256QAM, FEC 2/3, 32k, GI 19/256, PP2;
- BW 8MHz, 256 QAM, FEC 2/3, 32k, GI 19/256, PP4;
- BW 8MHz, 256 QAM, FEC 3/4, 32k, GI 19/256, PP2;
- BW 8MHz, 256 QAM, FEC 3/4, 32k, GI 19/256, PP4;
- BW 8MHz, 256 QAM, FEC 2/3, 32k, GI 1/8, PP2;
- BW 8MHz, 256 QAM, FEC 2/3, 32k, GI 1/8, PP2;

Optimizimi i mbulimit është organizuar në tre hapa:

- Së pari, nëpërmjet programin profesional të planifikimit të frekuencave audio/audiovizive “HTZ Communications”, u simuluan tetë konfigurimet e rrjetit të indentifikuara si më të përshtatshme. Konfigurimet me interval mbrojtje 1/8 paraqesin një nivel interferencash dukshëm më të vogël krahasuar me rastin kur intervali i mbrojtjes është 1/8.
- SFN-të paraqesin avantazhin e zgjerimit të rrjetit duke shtuar përsëritës pa nevojën e ri-planifikimit. Për përmirësim e zonës së mbuluar nga SFN Tiranë – Fier në konfigurimet e sipërpërmëndur shtohen katër përsëritësa (Gap Fillers) me fuqi 50 W, përkatësisht:

- ✓ Grabian
- ✓ Mali i Dajtit,
- ✓ Sheshi
- ✓ Kodër Durrës

Rezultatet tregojnë një mbulim më të mirë dhe nivel më të ulët interferencash.

➤ Së fundmi bëhet simulimi i vonesat statike të transmetuesve të SFN-së së re Tiranë-Fier me qëllim reduktimin e zonave të vet-interferuara. Ky simulim kryhet bazuar në programin profesional të planifikimit të frekuencave audio/audiovizive “HTZ Communications”. Niveli i interferencave përmirësohet me rreth 5%.

Koha e emetimit të secilit simbol COFDM mund të rregullohet (d.m.th., vonesat) në një përqindje të caktuar të intervalit të mbrojtjes. Ky quhet "rregullimi i vonesës statike SFN" dhe ndryshon konfigurimin e vonesës relative në secilin pikë të zonës së mbulimit.

Studimi i referohet rekomandimeve të ITU-së mbi humbjet e përhapjes së valës elektromagnetike, si dhe mbi aspektet teknike të planifikimit të rrjetit dhe frekuencës në teknologjinë DVB-T2, konkretisht:

- Rekomandimi ITU-R P.370-7 është një metodë parashikimi që përdoret në planifikimin e shërbimeve audiovizive në brezat VHF dhe UHF, që bazohet në njohuri mbi lartësinë e tokës. Ajo bazohet gjithashtu në një sintezë të matjes së forcës së fushës të marrë nga situata e ndryshme: ndryshueshmëria e vendndodhjes dhe kohës, lartësia e antenës transmetuese dhe marrëse, gradienti i indeksit të refraktimit atmosferik, lloji i brezit të frekuencës (VHF ose UHF) , tipi i rrugës së transmetimit (toka, deti i ftohtë, det i ngrohtë). Përveç kësaj, është e mundur që në një mënyrë opsionale të përfshijë korrigjimet e parregullsive në gjeometrinë e tokës, duke kërkuar pastaj njohuri të plota të vlerave të modelit digjital të lartësisë (DEM) përgjatë rrugës së transmetimit. Disi, ky model është statistikor, dhe zbatimi i tij është mjaft i shpejtë dhe i lehtë për t'u përdorur.
- Rekomandimi ITU-R 1546-5- “The method for point-to-area forecasts for terrestrial services in the frequency range 30 MHz to 3 000 MHz”. Rekomandimi ITU-R P.1546 është një metodë parashikimi pikë-hapësirë VHF / UHF (30MHz deri 3000MHz) për përdorim në planifikimin dhe koordinimin e shërbimeve të transmetimit tokësor audioviziv dhe të lëvizshmëm. Modeli bazohet në një grup thelbësor të kurbave që derivojnë nga matjet të cilat marrin në konsideratë faktorë të ndryshëm duke përfshirë: ndryshueshmërinë e vendndodhjes dhe kohës, lartësitë e antenave transmetuese dhe marrëse, kushtet atmosferike, gradientin e indeksit të thyerjes atmosferike, brezin e



frekuencave dhe tipin e rrugës së transmetimit (toka, deti i ftohtë, deti i ngrohtë dhe i përzier). Përveç kësaj, metoda përfshin korrigjimet për pengesat në tokë që rrjedhin nga një model digjital i lartësisë (DEM) përgjatë profilit të rrugës.

Një element i vlerësuar me kujdes në këtë punim, me ndikim të drejtëpërdrejt në përdorimin eficient të spektrit, është distanca e ripërdorimit të frekuencës për të shmangur interferencën ndërmjet kanaleve të njëjta (co-channel). Ky parametër ka një ndikim të rëndësishëm në numrin e kanaleve të kërkuara për të mbuluar një zonë më të madhe. Në këtë analizë janë marrë në konsideratë, gjithashtu, detyrimet e ndërsjellta që rrjedhin nga marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe dhe koordinimet ndërkombëtare të përdorimit të frekuencave.

Rezultat i këtij procesi është gjetja e konfigurimit të parametrateve teknik më të favorshme për mbulimin brenda kërkesave të rrjetit SFN Tiranë-Fier.

Në modelin teorik të marrësve COFDM DVB-T/T2, në rastin e SFN-ve, sasia e përgjithshme e sinjaleve të marra brenda intervalit të mbrojtjes në marrës kontribuojnë në fuqinë totale të sinjalit të dobishëm. Ndërkohë, jehona që vjen nga transmetuesit, vonesa relative e të cilëve tejkalon intervalin e mbrojtjes, kontribuojnë në fuqinë totale të sinjaleve interferuese.

Në tabelën 32 paraqiten parametrat që optimizohen apo ndikohen nga ky optimizim.

PARAMETRAT E TRANSMETIMIT	SFN TIRANE	SFN FIER	PARAMETRAT QE OPTIMIZOHET	PARAMETRA QE PREKEN NGA NDRYSHIMET
MËNYRA COFDM	32k-ext	32k-ext	-	-
INTERVALI I MBROJTJES	1/16	1/16	PO	-
MODULIMI	64 QAM	64 QAM	PO	-
KANALI UHF (FREKUENCA)	53 (730 MHz)	28 (530 MHz)	PO	PO
MODELI PILOT	PP4	PP4	PO	-
RAPORTI I KODEVE (FEC)	3/4	3/4	PO	-
KONSTELACION I RROTULLUAR	Po	Po	-	-
SHPEJTËSIA MAKSIMALE E BITIT	31.2 Mbps	31.2 Mbps	-	PO
CNR MINIMALE (RICE)	20.7 dB	20.7 dB	-	PO
DISTANCA MAKSIMALE SFN	39.7 km	28 km	-	PO

TABELA 32: PARAMETRAT TEKNIKË QË OPTIMIZOHEN APO INFLUENCOHEN NGA OPTIMIZIMI

### 5.3.1 SIMULIMI I VONESAVE STATISTIKE

Optimizimi i mbulimit bazuar në simulimin e vonesave statistike ka avantazhet e mëposhtme:

- Çdo operator rrjeti mund të zbatojë konfigurimin e vet të kompensimit të kohës pa ndikuar në shërbimin e rrjeteve të operatorëve të tjerë;
- Ndryshe nga rasti i ndryshimit të frekuencave, ndryshimi në kompensimin e kohës nuk kërkon një investim të konsiderueshëm;
- Konfigurimet e optimizuara të kompensimit të kohës përmirësojnë ndjeshëm mbulimin.
- Nëse identifikohet një zonë problematike, algoritmi lejon një llogaritje relativisht të shpejtë duke modifikuar konfigurimin e stacioneve të caktuara transmetuese dhe duke zbuluar ndikimin e këtyre modifikimeve në pika testimi të tjera,
- Nëse problemi nuk ka një zgjidhje me stacionet ekzistuese, ai mundëson dedektimin e shpejtë nëse shtimi i një stacioni përsëritës mund të zvogëlojë problemin.

Në SFN mundësohet një rregullim statik i vonesave në mënyrë që diferenca kohore e sinjaleve marrje të arrijë brenda Intervalit të Mbrojtjes. Rregullimi statik i vonesës kryhet duke përshtatur kohën e nisjes së sinjalit nga secili stacion transmetimi me një ndikim të drejtpërdrejtë në konfigurimin relativ të vonesës në secilën vendndodhje.

